**ALBANIAN UNIVERSITY**

# RAPORTI I VETËVLERËSIMIT PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL

GRUPI I VETËVLERËSIMIT**:**

| | | |
|---|---|---|
| 1. Prof. Asoc. Dr. Erda Qorri | Kryetar | Firma |
| 2. Prof. Asoc. Dr. Manuela Meçe | Anëtar | Firma |
| 3. Prof. Asoc. Dr. Genta Rexha | Anëtar | Firma |
| 4. Dr. Erion Piciri | Anëtar | Firma |
| 5. Dr. Eglantina Merkaj | Anëtar | Firma |
| 6. Erda Gjishti | Anëtar (Student) | Firma |

**19/09/2022**

## Përmbajtja

1. Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit..........................................................................4

2. Historiku i Albanian University............................................................................5

Rekomandimet e lëna nga Bordi i Akreditimit me Vendim nr. 01, datë 24.1.2020 për Akreditimin Institucional të Albanian University dhe plotësimi i tyre nga Institucioni..........7

Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për Akreditimin Institucional

I – Fusha e vlerësimit: Institucioni i Arsimit të Lartë, Menaxhimi, Autonomia dhe Sigurimi i Cilësisë..........................................................................................14

II – Fusha e vlerësimit: Burimet dhe Partneriteti ............................................................20

III – Fusha e vlerësimit: Programet e Studimit, Mësimdhënia dhe Vlerësimi...................33

IV - Fusha e vlerësimit: Aktiviteti Shkencor / Artistik dhe Inovacioni.............................48

V – Fushat e vlerësimit: Studentët dhe mbështetja e tyre ................................................54

Përfundimet dhe vlerësimi përgjithshëm......................................................................62

3. Lista e evidencave mbështetëse të RVB – Albanian University.........................................64

## SHKURTESA

| | |
|---|---|
| 1. AU | Albanian University |
| 2. QAA | Quality Assurance Agency (Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë) |
| 3. ASCAL | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë |
| 4. GVB | Grupi i Vlerësimit të Brendshëm |
| 5. APAAL | Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë |
| 6. BA | Bordi i Akreditimit |
| 7. VBA | Vendim i Bordit të Akreditimit |
| 8. VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| 9. ZZHK | Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave |
| 10. KKM | Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin |
| 11. RSH | Republika e Shqipërisë |
| 12. NJSBC | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë |
| 13. ZKKSHBA | Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike |
| 14. KSAU | Këshilli Studentor Albanian University |
| 15. MASR | Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë |
| 16. KSH | Kërkim Shkencor |

## 1. Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm është ngritur me Vendim Senati Akademik Nr. 7, datë 09/03/2022, Nr. 199/2 Prot.., **(Evidencë H.1)** në përputhje me legjislacionin në fuqi, "Manual për procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit'', 2017 i përgatitur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me mbështetjen e Agjencisë Britanike për Sigurimin e Cilësisë (QAA).

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB janë patur parasysh kompetencat profesionale, vlerësimi i paanshëm dhe objektiv, mundësitë për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit, aftësitë analitike, shkalla e njohjes së Institucionit dhe veprimtarive të tij, si dhe eksperienca të mëparshme në veprimtari të ngjashme vlerësuese. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm përbëhet nga 6 anëtarë, një prej të cilëve është student.

Në kuadër të hartimit të raportit, grupi ka vepruar me ndarje pune, detyrash dhe përgjegjësish të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Grupi në punën e tij ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të Albanian University, statutin, rregulloret dhe aktet e tjera rregullatore të tij. Grupit i janë vënë në dispozicion të gjitha të dhënat statistikore, raportet dhe dokumentacioni i punës së strukturave akademike dhe administrative të Institucionit, të cilat janë përfshirë në këtë raport.

## 2. Historiku i IAL

“Albanian University” (AU) është pjesë e shoqërisë “UFO SHPK” themeluar në datë 25/05/1994, dhe regjistruar sipas legjislacionit në fuqi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me Numër Unik të Identifikimit J82025002B - Numri i Niptit.

AU është themeluar në përputhje me legjislacionin në fuqi me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 10.04.2004 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “UFO dental””. Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 597, datë 28.5.2009 emërtimi i shkollës së lartë universitare, private “UFO dental" ndryshon në “UFO University”.
Në përputhje me legjislacionin në fuqi me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 603, datë 24.8.2011 u vendos ndryshimi i emrit të universitetit privat nga “UFO University” në “Albanian University”.
“Albanian University” hapi dyert në vitin akademik 2004 - 2005, me kursin e parë të studimeve të Stomatologjisë, me rreth njëqind studentë. Që në vitin e parë të krijimit të tij, ky institucion vuri në qendër të jetës akademike promovimin e produktit intelektual dhe shkrirjen e mësimit me kërkimin shkencor, e finalizuar me Konferencën e Parë Stomatologjike “UFO Dental”, e cila hapi siparin e një tradite tashmë të konsoliduar. Në vitin akademik 2005 – 2006, Institucioni ofroi diploma universitare edhe në degët: Farmaci, Arkitekturë, Shkenca Juridike dhe Shkenca Politike. Programe bashkëkohore studimi, staf me një formim shumë të gjatë si akademik dhe profesional, kushte infrastrukturore moderne dhe cilësore janë disa nga elementët mbi të cilët u zhvillua Universiteti. Në vitin akademik 2006 -2007, Universiteti u plotësua me të tetë degët e tij të studimit: Stomatologji, Farmaci, Arkitekturë, Financë - Bankë, Shkenca Juridike, Shkenca Politike, Psikologji, Shkenca Komunikimi, dhe pranë tij ndoqën studimet rreth 2000 studentë. Në këtë vit akademik, përveç plotësimit të detyrave akademike, Universiteti vuri theksin në përfshirjen e akademikëve në debatet dhe çështjet publike. Forumet, workshop-et, seminaret, konferencat, debatet kanë përfshirë jo vetëm akademikët, por edhe studentët, si dhe grupet e interesit, parë si pjesë e formimit intelektual drejt realizimit të misionit të Universitetit. Në prill të vitit 2007, përveç UFO Press, universiteti zgjeron hapësirën e tij publike nëpërmjet televizionit “UFO Education”. Ai u ideua si një televizion edukativ në çdo dhënie informacioni. Synimi i tij ishte formimi kulturor në aspektet politike, artistike, letrare, duke u përpjekur të transmetojë vlerat më pozitive të shoqërisë globale. Viti akademik 2008 - 2009, erdhi me prova të reja për Universitetin. Në këtë vit akademik, universiteti u përball me sfida të reja duke ofruar programe të reja të nivelit të dytë dhe të tretë, të cilët ndihmojnë edhe në profilizimin dhe specializimin e studentëve të tij, për t’i afruar sa më shumë me tregun e punës. Viti akademik 2009 - 2010 ishte viti i konsolidimit cilësor të universitetit; në këtë vit të gjitha programet *Bachelor* dhe programet e integruara Farmaci, Stomatologji dhe Arkitekturë, kaluan procesin e akreditimit dhe në vitin 2010 u vlerësuan pozitivisht nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë. Viti akademik 2011 - 2012 shënon një vit tjetër të rëndësishëm në jetën akademike të Universitetit, sepse në këtë vit akademik hapet cikli i tretë i studimeve i specializimeve afatgjata në fushën e stomatologjisë me 8

drejtimet e saj, ku lëndët e praktikës organizohen me profesorë të huaj. Ky vit shënon edhe një numër të madh aktivitetesh shkencore dhe kulturore në të gjithë departamentet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, të pasqyruara edhe në revistën e Universitetit "Optime", si dhe një numër i madh botimesh të reja dhe ribotimesh të shtëpisë botuese "UFO Press". Viti akademik 2012 - 2013 përbën një vit të rëndësishëm sepse shënon 10 vjetorin e hapjes së aktivitetit të shërbimit privat në fushën e arsimit. Ky vit ofroi edhe një gamë më të gjerë programesh të ciklit të dytë, master profesional në fushën e infermierisë dhe të psikologjisë, sikurse edhe hapjen e programeve të ciklit të tretë të doktoraturave në fushën e shkencave juridike, ekonomike, psikologji, shkenca politike, shkenca farmaceutike dhe arkitekturë.
Gjatë viteve 2014 -2017 institucioni punoi fort në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të ofruara duke lidhur marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi me Universite Italiane, Austriake, Rumune etj., falë të cilave u realizuan programe Erasmus+ dhe projekte ndërkombëtare me impakt pozitiv për stafin dhe studentët. Albanian University përfundoi me sukses akreditimin e 29 programeve Bachelor dhe Master si dhe akreditimin institucional. Albanian University është akredituar për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 90, datë 20.10.2017 nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në bashkëpunim me QAA (Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë), dhe riakredituar me Vendim të Bordit Nr. 01, datë 24.01.2020.

Përgjatë viteve akademike 2018 – 2019 dhe 2019 – 2020, Institucioni pati në vëmendjen e tij përshtatjen e programeve të studimit me aktet e reja rregullatore të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, të cilat morën miratimet përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin. Gjatë vitit akademik 2020 – 2021, Albanian University ofron programet të ndryshme studimi në tre ciklet e studimit dhe programet me karakter profesional, duke qenë koherente me kërkesat e tregut të punës dhe sjelljen e risive me programe të reja studimi. *Ky vit, është një vit jubilar pasi përkon me 10 vjetorin e hapjes së programeve specializuese afatjata në fushën e stomatologjisë, Kirurgji Orale dhe Ortognatodoncisë.* Këto studime të ciklit të tretë janë një vlerë e shtuar jo vetëm e programit të stomatologjisë, por edhe e fushës së shëndetësisë duke kontribuar në formimin e specialistëve të shëndetit oral në vend. Ky vit akademik përkon gjithashtu, me një situatë të pazakontë, siç është ajo e pandemisë Covid-19, e cila detyroi zhvillimin e mësimdhënies në distancë. Albanian University dixhitalizoi dhe implementoi në kohë reale zhvillimin me sukses të të gjitha programeve të studimit që ofron në platformën Microsoft Teams.

Sot AU është një emër i konsoliduar në arsimin e lartë privat në Shqipëri me numrin më të lartë të studentëve aktivë dhe atyre të diplomuar ndër universitetet privatë. Gjeneratat e të diplomuarve, të cilët mbartin kombësi të ndryshme kanë gjetur veten në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar apo në thellimin e njohurive të tyre akademike.

**RAPORT MBI PLAN VEPRIMIN PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA BORDI I AKREDITIMIT NË VENDIMIN NR. 1 DATË 24.01.2020 "PËR AKREDITIMIN PERIODIK TË INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË "ALBANIAN UNIVERSITY""**

"Albanian University" pasi u vu në dijeni me VBA Nr. 1, datë 24.01.2020 për akreditimin periodik institucional, ndërmori menjëherë masat për ngritjen e grupeve të punës për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga ky vendim **(Evidencë H.2)**. Grupet e punës hartuan plan-veprimin për rekomandimet e lëna nga bordi i akreditimit dhe materiali u dërgua në ASCAL brenda afatit 6-mujor bazuar në "Manualin për procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit'', 2017 me shkresë Nr. 148 Prot., dt. 17.06.2020 **(Evidencë H.3*).***

**Për përmbushjen e rekomandimeve gjeni si më poshtë vijon:**

***Rekomandimi nr. 1 (shtojca) Institucioni, të ndjekë një politikë të qartë për të siguruar koherencën e programeve të studimit dhe të ndërmarrë një vlerësim të përgjithshëm të indikatorëve cilësorë dhe sasiorë mbi kapacitet reale të disponueshme.***

Grupi i punës, bazuar në këtë rekomandim, filloi zbatimin e masave të plan-veprimit **(Evidencë R.1)**, konkretisht Faza 2 me analizën e situatës aktuale të programeve të studimit bazuar në:

**Indikatorët cilësorë:**

- rezultatet e vlerësimeve të jashtme (akreditimeve),
- rishikimi dhe përditësimi i kurrikulave në përputhje me tregun e punës dhe aktet nënligjore në fuqi.

**Indikatorët sasiorë:**

- Statistika të regjistrimit të studentëve në 5 vitet e fundit,
- kapacitetet infrastrukturore,
- burimet njerëzore në mbështetje të tyre.

*Përsa i përket indikatorëve cilësorë për rezultatet e vlerësimeve të jashtme (akreditimeve), rezulton se "**Albanian University" ofron 41 programe aktive studimi, të cilat janë të akredituara me Vendime të Bordit të Akreditimit*** **(Evidencë R.2. tabela nr 1*).*** *Të gjitha këto programe studimi janë hartuar dhe zhvillohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke përmbushur standardet shtetërore të cilësisë, si dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Në mënyrë periodike, të gjitha programet aktive të studimit kanë kaluar procesin e vlerësimit të jashtëm nga ASCAL dhe janë vlerësuar pozitivisht nga Bordi i*

*Akreditimit. Mbarëvajtja e këtij procesi dhe realizimi i tij në përputhje me legjislacionin në fuqi është në qendër të veprimtarisë së Institucionit.*

*Gjatë tre viteve të fundit programet e studimit kanë kaluar me sukses procesin e akreditimit dhe janë vlerësuar pozitivisht nga Bordi i Akreditimit me 3-6 vite të kohëzgjatjes së akreditimit* (**Evidencë R.2, Grafiku Nr. 1**). ***Kohëzgjatja e akreditimeve ka ardhur në rritje vitet e fundit gjë e cila tregon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies në "Albanian University".***

Albanian University ka kaluar procesin e vlerësimit të jashtëm për disa programe studimi në vitin akademik 2021 - 2022, për të cilat është në pritje të vendimit nga Bordi i Akreditimit.

- rishikimi dhe përditësimi i kurrikulave në përputhje me tregun e punës dhe aktet nënligjore në fuqi.

***Zhvillimi i vazhdueshëm i programeve të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës, nevojat social – ekonomike të vendit, si dhe strategjinë për zhvillim të institucionit është një ndër objektivat strategjikë të sigurimit të cilësisë në "Albanian University".***

"Albanian University" ofron Programe Studimi që janë në përshtatje me kurrikulat e vendeve të zhvilluara, si edhe në përputhje me Kartën e Bolonjës, një kriter i përgjithshëm i zbatuar nga Arsimi i Lartë Shqiptar.

Të gjitha ndryshimet bazohen në nevojat e tregut të punës, studime të cilat hartohen në rang Institucioni, **(Evidencë R.3)** Departamenti **(Evidencë R.4.a.b.c),** bazuar në të dhënat e mbledhura nga punësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve **(Evidencë R.5)**, si dhe në rekomandimet e Vlerësimit të Jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të studimit.

Në zbatim të akteve nënligjore në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, si VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "*Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*"dhe Udhëzimit Nr. 31 datë 29.12.2017 "*Për Përcaktimin e Kritereve, Dokumentacionit dhe Procedurave për Hapjen, Riorganizimin dhe mbylljen e Programeve të Studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", i azhornuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "*Për Dokumentacionin dhe Procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen dhe bashkimin e institucionit të arsimit të lartë*", "**Albanian University" *është kujdesur që të gjitha programet e studimit të rishikoheshin në përputhje me to. Ky proces u realizua me sukses, duke u finalizuar me marrjen e miratimeve përkatëse nga ministria përgjegjëse për arsimin, për zbatimin e programeve të ndryshuara* (Evidencë R.2, tabela nr.2).**

**Përsa i përket Indikatorëve sasiorë:**

- **Statistika të regjistrimit të studentëve në 5 vitet e fundit**

"Albanian University" ofron një diversitet diplomash në tre ciklet e studimit. ***Si i tillë interesi i studentëve të regjistruar ndër vite ka qenë në rritje***, çka dëshmon rritjen e cilësisë dhe arritjeve në "Albanian University" falë vlerave si: korrektësia organizative, cilësia në çdo iniciativë akademike, përgjegjshmëria në arritjen e standardeve.

Sipas të dhënave të INSTAT, në vitin 2021, në nivel kombëtar, numri i studentëve që ndjekin arsimin e lartë është rreth 124 mijë. “Albanian University” vijon të jetë Universiteti më i madhi privat në vend me 15% të studentëve të regjistruar pranë tij (**Evidencë R.6)** gjë që tregon besueshmërinë e të rinjve për zgjedhjen e këtij institucioni arsimor.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 3 **(Evidencë R.2, tabela nr.3)** , numri më i madh i studentëve të regjistruar në 5 vitet e fundit, në nivel programi studimi është arritur në vitin akademik 2018 – 2019, në programin e studimit "Bachelor" në "Infermieri" me 420 studentë të regjistruar.

Të dhënat e regjistrimit të studentëve janë reflektuar dhe në Grafikun nr. 2 **(Evidencë R.2, grafiku nr.2)** për periudhen akademike 2017 - 2022.

- **Indikator sasior - kapacitetet infrastrukturore,**

"Albanian University", ushtron aktivitetin akademik në katër godina universitare:

- Godina 1, Bulevardi Zogu I (ish Estrada),
- Godina 2, Rruga e Durrësit (ish Gjykata),
- Godina 3, Rruga K. Karafili (ish Internacionali),
- Godina 4, Rruga e Kavajës.
- Godina 5, Klinika Rruga e Kavajës

për të cilat disponon kontratat e qerasë të cilat janë afatgjatë, pasi tashmë prej 18 vitesh ky Institucion ushtron veprimtarinë e tij në këto godina.

“Albanian University” disponon një sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 11,229 $m^2$, të cilat janë të pajisura me "Akt Miratimi Higjieno-Sanitar" dhe "Akt Teknik" për mbrojtjen nga zjarri i lëshuar nga PMNZSH ***(Evidencë R.7.a.b.c.d). Këto ambjente verifikohen nga MAS dhe janë objekt miratimi si kapacitete për kuotat e vitit akademik*** **(Evidencë R.8.a.b.c)**. Nga përllogaritjet e hapësirave fizike për Fakultetin e Shkencave Mjekësore dhe përdorimit të të gjitha godinave të AU, kemi raportin 5 $m^2$ për student. Kriteret plotësohen edhe për departamentin e Inxhinierive dhe departamentin e Art-Dizajn , të cilët përdorin 5.6 $m^2$ për student, Fakulteti i Shkencave Shoqërore përdorin minimalisht 4,3 $m^2$ për student dhe Departamenti Shkencave Ekonomike përdor 2.5 $m^2$ për student.

- **Indikator sasior - burimet njerëzore në mbështetje të tyre.**

Numri i stafit akademik të angazhuar pranë “Albanian University” është në përputhje me numrin e studentëve duke respektuar raportet sipas përcaktimeve ligjore. Ata janë me grada dhe tituj dhe me një përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies. **(Evidencë R.2, Tabela 5**).

Nga raporti per vleresimin e kapaciteteve **(Evidencë R.8.c)** është konstatuar se:

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka raportin 1 pedagog/21 studentë,

2. Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka raportin 1 pedagog/26 studentë,

3. Fakulteti i Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike ka raportin 1 pedagog/35 studentë.

*Rekomandimet nga 2-6 (kërkimi shkencor)*

***R 2. Institucioni, të hartojë një plan të ri strategjik të kërkimit shkencor, të bazuar në shtyllat kryesore të zhvillimit dhe të lidhur me një plan veprimi afatshkurtër dhe afatgjatë, me qëllim ngritjen e kërkimit shkencor në nivel Universiteti.***

***R 3. Institucioni, të percaktojë qartë prioritetet e kërkimit shkencor, të fokusuara drejt ndërkombëtarizimit, inovacionit dhe projekteve kërkimore.***

***R 4. Institucioni, të rrisë buxhetin dedikuar kërkimit shkencor, jo vetëm për pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe publikime, por dhe investimin në projekte kërkimore, pjesë të strategjisë së kerkimit shkencor.***

***R 5. Institucioni, të themelojë/ngrejë një sistem monitorimi në nivel Universiteti, pergjegjës për zbatimin e strategjisë së kërkimit, vlerësimin e kërkimit shkencor dhe monitorimin e progresit dhe rezultateve të kërkimit shkencor.***

Në përmbushje të ***rekomandimit R.2,*** bazuar në Vendimin e Rektoratit datë 09.03.2020, grupi i punës duke patur në vëmendje Strategjinë e tij të Kërkimit Shkencor 2017 - 2022 **(Evidencë R.9.a)**, si dhe bazuar në shtyllat kryesore të zhvillimit të kërkimit shkencor në vend ka hartuar ***një plan të ri strategjik të kërkimit shkencor miratuar me VS Nr. 14, Nr. 406/1 Prot., dt.31.05.2021*** **(Evidencë R.9.b)**.

***Gjithashtu për rekomandimin R.3,*** grupi i punës pasi realizoi një analizë të situatës aktuale të kërkimit shkencor në "Albanian University" duke evidentuar bërthamat e kërkimit shkencor në nivel Departamenti, analizën e infrastrukturës së disponueshme dhe të burimeve njerëzore aktuale, analizën e prioriteve strategjike kombëtare dhe përcaktimi i kontributit të mundshëm të AU në këtë panoramë ***hartoi një strategji ndërkombëtarizimi në nivel Institucional*** **(Evidencë R.10).**

"Albanian University" nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve në veprimtaritë e ndryshme kërkimore – shkencore dhe ***për rekomandimin R.4, R.5 dhe R.6***, Institucioni ka punuar dhe ka arritur të jetë pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (https://albanianuniversity.edu.al/sq/albanian-university-lidh-marreveshje-me-akademine-e-shkencave/). Në kuadër të këtij bashkëpunimi **(Evidencë R.11, neni 4),** dhe aktivitizimit të stafit të "Albanian University" në Njësisë Kërkimore NANO-SHKENCA & NANO-TEKNOLOGJIA (NanoAlb), është aplikuar si partner në thirrjen HORIZON-WIDERA-2022-ACCESS-01-two-stage. Gjithashtu, AU në kuadër të ligjit ''Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë'', Nr. 80/2015**,** ka Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. Kjo zyrë synon të evidentojë mundësitë e ndryshme për aplikime në projekte, të mbështesë stafet akademike në aplikime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar **(Evidencë 12.a)** etj.

***Nën kujdesin e Zyrës është aplikuar me 4 projekt propozime në thirrjen e përbashkët midis Shqipërisë dhe Turqisë dhe 4 projekt propozime në thirrjen e projekteve kombëtare të***

***kërkimit dhe të zhvillimit (PKKZH) 2022 (dy nga projektet janë të koordinuara nga "Albanian University" dhe dy si partner)* (Evidencë R.12.b).** Gjatë vitit 2021 – 2022, Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve akademike ka aplikuar si partner edhe me 8 projekt propozime në programin Erasmus+, 1 aplikim në programin Horizon Europe (i cili ka rezultuar fitues dhe implementimi ka filluar nga 20.06.2022) dhe është aplikuar për 4 marrëveshje të reja shkëmbimi në kuadër të programit Erasmus+ (krahas rinovimit të marrëveshjeve aktuale me Universitetet partnere).

Një numër i konsiderueshëm projektesh janë aplikuar dhe ***implementohen*** në AU, nga ku mund të përmendim: Projektin GRADUA (https://albanianuniversity.edu.al/sq/gradua-2/) **(Evidencë R.13.a),** Projekti me Arkivat e Shtetit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/ceremonia-e-dhenies-se-certifikatave-studenteve-te-fakultetit-te-shkencave-shoqerore/) **(Evidencë R.13.b)** *në të cilën studentët u pajisën me certifikata* **Evidencë R.13.b.1),** Projekti me Kuvendin e Shqipërisë realizohet në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy institucioneve (**Evidencë R.13.c),** si dhe janë organizuar evente të ndryshme shkencore, të cilat publikohen në faqen zyrtare të website (https://albanianuniversity.edu.al/sq/konference-shkencore-nderkombetare-me-rastin-e-100-vjetorit-te-miratimit-te-rregullores-se-pare-te-kuvendit-te-shqiperise/)**,** Projekti "Disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme" **(Evidencë R.13.d)**, Projekti RESILIENCE (https://albanianuniversity.edu.al/sq/resilience-2/) **(Evidencë R.13.e*)*,** Projekti CEI extraordinary Call "Distance learning on epidemic and pandemic outbreaks in Western Balkans (ref. n. 305.1521-20), Projekti 'Support to enhance the organisation and governance of the Institute, strengthen its capacity for data collection, epidemiological analysis, and monitoring, and improve its emergency response for communicable diseases and cross-national threats' Twinning Reference Number: AL 20 IPA HE 01 21 TWL EuropeAid/172817/ID/ACT/AL, Projekti "Innovation Eco-system to Accelerate the Industrial Uptake of Advanced Surface Nano-Technologies" (https://www.newskin-oitb.eu/), i cili zbatohet në kuadër të Qendrës "Albanian University Center" (https://albanianuniversity.edu.al/sq/au-center/) etj.

Institucioni, gjithashtu, parashikon në buxhetin e tij vetëfinancime të projekteve kërkimore – shkencore në ciklin e tretë të specializimeve afatgjata në Stomatologji. Falë këtij projekti është bërë i mundur studimi i ekspansionit të shpejtë me minivida, rezultatet e të cilit bëhen të dukshme nëpërmjet publikimeve në revista shkencore prestigjioze (https://www.ajodo.org/article/S0889-5406(21)00044-5/ppt) **(Evidencë R.14)** Gjithashtu, studentë të programeve të integruara master i shkencave nxiten të realizojnë punimet e tyre me tema eksperimentale realizuar pranë laboratorëve të AU dhe rezultatet e kërkimeve publikohen në Revistën "Optime", periodik shkencor i Universitetit **(Evidencë R.15).** Bazuar në sa më sipër dhe në evidencat e vëna në dispozicion nga Institucioni, buxheti i alokuar për kërkimin shkencor në total është 7.2%, ku 4 % janë shpenzimet për kategorinë e kërkimit shkencor, miratuar me Vendim Senati Nr. 54. datë 23.12.2021, Nr.1224/1 Prot., **(Evidencë R.16**) duke patur ***një rritje nga konstatimet e mëparshme***. Gjithashtu, Institucioni nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta me pedagogë aplikues dhe fitues të fondeve të projekteve

kërkimore shkencore ka qenë përftitues i Projektit Horizon 2020 HYPOSENSE (http://hyposens.eu/).

Një element kritik i një strategjie kërkimore efektive është përfshirja e proceseve për vlerësimin e progresit në lidhje me qëllimet e strategjisë dhe për përsosjen dhe përshtatjen e strategjisë ndërsa baza e informacionit zhvillohet dhe nxit nevoja për ndryshim. Në fazën fillestare, u krijua një grup ekspertësh i përbërë nga anëtarë të komisioneve dhe njësive bazë. Numri i individëve u bazua në numrin e fakulteteve dhe programeve të studimit të AU, ekspertiza e tyre e cila duhej të ishte e pasur në publikime shkencore, eksperiencë në ekspertizë publikimesh dhe vlerësimesh shkencore. Në fazën e dytë ekspertët përcaktuan faktorët e vlerës së indekseve të çdo drejtimi kërkimor. Më e rëndësishme është analiza dhe hulumtimi krahasues i tendencave në karakteristikat përfundimtare, i cili tregon një tendencë në rritje të numrit të aplikimeve në projekte, ku projektet ndërkombëtare në rang universiteti paraqesin një rritje me 9 projekte, aplikime kombëtare me 8 projekte dhe vërehet një trend në rritje i publikimeve shkencore i cili ka ndihmuar rritjen e visibilitetit të AU dhe rankimin e tij ne rang kombëtar dhe ndërkombëtar. (https://www.adscientificindex.com/university/Albanian+University/) **(Evidencë R.17) (Evidencë R.18).**

***R 6. Institucioni, të përmirësojë profilin ndërkombëtar të programeve master dhe doktoratë, të stimulojë mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve, si dhe të perfshijë me tepër studentët në projekte kërkimore shkencore dhe programe mobiliteti ndërkombëtare.***

AU në zbatim të politikave kombëtare për ndërkombëtarizimin e programeve të studimit të IAL- ve në kuadër të partneriteve me institucione universitare të huaja ka aplikuar në MAS për programe studimi të përbashkëta në fushën e stomatologjisë me universitetin e Ferrarës miratuar me Urdhër Nr. 444, dt 22.07.2022 Nr.4941/1 Prot.. Veprimtaria akademike e programit të përbashkët të integruar "Master i Shkencave" në "Odontoiatria e Protesi Dentaria" fillon në vitin akademik 2022 - 2023. Në kuadër të programit të ciklit të tretë specializime afatgjata në Kirurgji Orale, Institucioni bashkëpunon me Universitetin e Napolit Federico II, Klinikën Spitalore Umberto I, me të cilin shkëmben stafin dhe studentë të tij, gjithashtu falë bashkëpunimeve me universitet partenere ka rritur ndjeshëm numrin e shkëmbimeve të stafit dhe studentëve falë programeve Erasmus + (**Evidencë R.19)** me Universitetin e Salernos, Itali, Universitetin Biruni, Turqi, Universitetin Jyvaskyla, Finlandë, Universitetin e Pisës, Itali, Kirchliche Pedagogische Hochschule Wien/Krems, Austri etj,. Studentët nxiten në punime kërkimore, të cilat realizohen në laboratorët e Universitetit nëpërmjet vetëfinancimeve ose në bashkëpunim me universitetet partenere ku studentët kanë realizuar programet e shkëmbimit Erasmus, ata kanë arritur të sjellin nëpërmjet temave të diplomës eksperimentale rezultatet e punimeve të tyre **(Evidencë R.20**). Në kuadër të ndërkombëtarizimit, falë bashkëpunimeve me qendra spitalore ndërkombëtare është realizuar shkëmbimi me studentët e ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në stomatologji pranë këtyre institucioneve për realizimin e praktikave profesionale, intershipeve **(Evidencë R.21**).

Përsa i përket ciklit të tretë, Doktoratë, në bashkëpunim me Universitetet partnere të huaja do të aplikohet për riorganizimin e 3 programeve Doktoratë në përputhje me kriteret e reja

ligjore në fuqi, si dhe 2 programe të reja. Institucioni ka vënë në dispozicion buxhetin e nevojshëm për implementimin e tyre. Buxheti i alokuar është miratuar nga Bordi i Administrimit të AU **(Evidencë R.16)**.

***Rekomandim nr. 7 Paaftësia e stafit akademik për të kuptuar dhe folur gjuhën angleze, për të cilën institucioni ende nuk ka marrë masat e nevojshme, ndikon në punën kërkimore shkencore dhe ndërkombëtarizimin e programeve të studimit.***

Në zbatim të rekomandimit **R.7 në fazën e parë,** Institucioni mori masat për zhvillimin e trajnimeve për përmirësimin e të dëgjuarit dhe të komunikuarit në gjuhën angleze për stafin akademik **(Evidencë R.22)**.

Zhvillimi i trajnimeve dhe leksioneve të hapura për përmirësimin e shkrimit të artikujve kërkimorë-shkencorë dhe projekteve në gjuhën angleze nga stafi akademik, u realizuan nën kujdesin e Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike https://albanianuniversity.edu.al/sq/?s=trajnimi+shkrimi+akademik **(Evidencë R.23).**

Në vazhdim, Institucioni do të vazhdojë angazhimin e tij në këtë drejtim, në mënyrë të veçantë në drejtim të trajnimeve për përmirësimin e shkrimit të artikujve kërkimorë-shkencorë dhe projekteve në gjuhën angleze nga stafi akademik.

## I – INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË, MENAXHIMI, AUTONOMIA DHE SIGURIMI I CILËSISË

**Standardi I.1 Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit.**

Universiteti "Albanian University" e ushtron veprimtarinë dhe aktivitetin e tij, në përputhje me ligjin 80/15 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përshtatje me misionin dhe objektivat e tij ka hartuar të gjitha aktet normative: Statutin **(Evidencë Nr. 1.1)** me Vendim të Senatit Akademik Nr 203., Prot 28.09.2016 **(Evidencë Nr. 1.2)** miratuar me Urdhër Nr. 596 dt. 21.12.2016 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë **(Evidencë 1.3),** Rregulloren e Përgjithshme (**Evidencë 1.4)** miratuar me Vendim Senati Nr. 12, datë 03.05.2017 (**Evidencë 1.5),** si dhe në përputhje me to të gjitha aktet e tjera normative të Institucionit, si: Rregulloret e Njësive Kryesore, Rregulloret e Njësive Bazë, Rregulloret e Programeve të Studimit, si dhe çdo Rregullore tjetër, e cila parashikohet në Statut.

Në AU të gjitha aktet normative janë objekt i rishikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

**Standardi I.2 Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë eficiencë në menaxhim.**

Në AU, Rektorati harton planin strategjik të zhvillimit të Institucionit, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe kryesore, si dhe të Administratorëve të njësive kryesore dhe ia paraqet për miratim Senatit Akademik **(Evidencë 1.4 Neni 5, fq. 6).**
Administratori i Përgjithshëm, njëherazi anëtar i Rektoratit, mbështetur në propozimet e njësive bazë, harton projektbuxhetin vjetor dhe atë afat mesëm 3-vjeçar të AU. Senati i propozon për miratim Bordit të Administrimit, projektbuxhetin vjetor dhe atë afat mesëm 3-vjeçar të AU, hartuar nga Administratori i Përgjithshëm **(Evidencë 1.4 Neni 9, fq. 11).**

Bordi i administrimit vendos rregullat për mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave që siguron Institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij dhe ja përcjell organeve drejtuese akademike.

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të Institucionit të Arsimit të Lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Organizimi i brendshëm dhe kontrolli në AU bëhet në përputhje me përcaktimet në Statut (**Evidencë Nr. 1.1**) dhe në Rregulloren e Përgjithshme **(Evidencë Nr. 1.4).**

**Standardi I.3 Institucioni harton një strategji zhvillimi.**

Kuadri Institucional aktual në "Albanian University" kërkon t'i përgjigjet zhvillimeve të kohës. Për këtë AU harton dhe adopton në vazhdimësi strategji zhvillimi. Zhvillimi strategjik i AU është bazuar në planin strategjik për periudhën 2017 - 2022 **(Evidencë 1.6)**, i cili pasi është diskutuar në organet kolegjiale përkatëse, është miratuar në Senatin Akademik me Vendim Nr. 14, dt. 28.12.2016 **(Evidencë 1.7)**. Strategjia është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit. Në Planin Strategjik të Institucionit përcaktohen: cilësia e lartë në menaxhim, kërkim dhe zhvillim, me qëllim krijimin e një komuniteti kombëtar, rajonal e më gjerë, i cili bazohet në një zhvillim të qëndrueshëm. Ky zhvillim, në bazë të strategjisë mund të realizohet më së miri në sajë të një bashkëpunimi të vazhdueshëm, i cili konsiston në

këmbimin e eksperiencave në të gjitha format e veta midis Institucioneve të Arsimit të Lartë Kombëtar dhe Ndërkombëtar. Në kuadër të implementimit të strategjisë, AU realizon edhe planin e masave me qëllim monitorimin dhe zbatimit cilësor të saj **(Evidencë 1.8).**

**Standardi I.4 Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij.**

AU i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe formimit të kulturës së cilësisë në Institucion **(Evidencë 1.9)**. Për këtë qëllim, në AU është ngritur struktura e cilësisë, që përbëhet nga Komisioni për Vlerësim Institucional dhe nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Komisioni për Vlerësim Institucional është ngritur me Vendim Senati Akademik Nr. 4, datë 22.12.2016 **(Evidencë 1.10)**, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe është përgjegjës për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të brendshëm të cilësisë në AU.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është ngritur që në vitin 2010 me Vendim të Senatit Akademik datë 23.07.2010 Nr. 178 Prot.., **(Evidencë 1.11)** konform udhëzimeve të APAAL (aktualisht ASCAL) dhe Standardeve Shtetërore të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe është përgjegjëse për të gjitha çështjet e lidhura me cilësinë e brendshme, të cilat kanë si qëllim përmirësimin dhe ruajtjen në nivel të lartë të shërbimeve akademike dhe administrative të AU.

Sigurimi i cilësisë në AU fillon në nivel Njësie Bazë me ngritjen e grupeve *ad hoc*, të cilët merren me çështje të tilla si rishikimi dhe përditësimi i syllabuseve dhe kurrikulave, vlerësimi i programeve të ndryshme të studimit dhe çështje të tjera që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe procesit mësimor dhe kërkimor shkencor **(Evidencë 1.12 a,b)**.

AU bazuar në nevojat e tij, si dhe në kuadër të marrjes së vendimeve sa më objektive dhe efikase, ndër vite ka angazhuar këshilltarë të jashtëm. Aktualisht, pranë AU janë angazhuar 1 konsulent juridik dhe 1 konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave **(Evidencë 1.13 a,b,)**.

AU është organizuar në mënyrë të tillë që të përfitojë financime nga programet europiane dhe me gjerë. Për këtë qëllim, në Institucion angazhohet Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, në bashkëpunim me strukturat e tjera. Konkretisht, Njësitë Bazë informohen dhe motivohen për të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara në kuadër të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe mbështeten në pjesëmarrjen konkrete në projekte **(Evidencë R.12.b).**

AU ka fituar disa projekte të listuara më poshtë dhe është në proces të zbatimit të tyre:

1. Projekti GRADUA (https://albanianuniversity.edu.al/sq/gradua-2/ )**(Evidencë R.13.a),**

2. Projekti me Arkivat e Shtetit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/ceremonia-e-dhenies-se-certifikatave-studenteve-te-fakultetit-te-shkencave-shoqerore/ )**(Evidencë R.13.b)**.

3. Projekti me Kuvendin e Shqipërisë (https://albanianuniversity.edu.al/sq/konference-shkencore-nderkombetare-me-rastin-e-100-vjetorit-te-miratimit-te-rregullores-se-pare-te-kuvendit-te-shqiperise/) **(Evidencë R.13.c)**

4. Projekti "Disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme" **(Evidencë R.13.d),**

5. Projekti RESILIENCE (https://albanianuniversity.edu.al/sq/resilience-2/ )**(Evidencë R.13.e)**

6. CEI extraordinary Call "Distance learning on epidemic and pandemic outbreaks in Western Balkans" (ref. n. 305.1521-20)

7. "Support to enhance the organisation and governance of the Institute, strengthen its capacity for data collection, epidemiological analysis, and monitoring, and improve its emergency response for communicable

diseases and cross-national threats" Twinning Reference Number: AL 20 IPA HE 01 21 TWL EuropeAid/172817/ID/ACT/AL.

8. Projekti "Innovation Eco-system to Accelerate the Industrial Uptake of Advanced Surface Nano-Technologies" (https://www.newskin-oitb.eu/), i cili zbatohet në kuadër të Qendrës "Albanian University Center" (https://albanianuniversity.edu.al/sq/au-center/), etj.

AU ka aplikuar në një sërë projektesh, të cilat i ka fituar dhe disa janë në proces vlerësimi **(Evidencë R.12).**

**Standardi I.5 Institucioni favorizon debatin konstruktiv.**

Vendimmarrja në organet kolegjiale në AU bëhet sipas një procedure të caktuar, duke respektuar të drejtën e kujtdo, i cili/e cila është anëtar i këtyre strukturave.

Në AU, Rektorati është organ kolegjial ekzekutiv dhe kryesohet nga Rektori. Mbledhjet e Rektoratit realizohen 1 herë në muaj dhe zhvillohen kur janë të pranishëm të paktën 50% e anëtarëve. Rektorati i aprovon vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm **(Evidencë 1.14, neni 3&4).**

Senati Akademik është organi kolegjial vendimmarrës më i lartë në nivel Universiteti. Mbledhjet e Senatit Akademik thirren me një rend dite të përcaktuar, propozuar nga Kryetari **(Evidencë 1.15, neni 16).** Njoftimi për mbledhjen e Senatit u dërgohet anëtarëve, me shkresë ose email. Njoftimin e organizon Rektorati. Mbledhjet e Senatit, në zbatim të Nenit 20, pika 1 të Statutit të AU zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave, me përjashtim të rasteve kur Statuti parashikon ndryshe. Senati Akademik, sipas rregullimeve të parashikuara shprehimisht në Statut dhe në Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tij, mblidhet periodikisht në sesione të rregullta, 3 (tri) herë në një semestër **(Evidencë 1.15, Neni 20).** Vendimet e Senatit nënshkruhen nga Kryetari i tij dhe përcillen brenda 5 ditëve nga përfundimi i mbledhjes përkatëse. Vendimet përcillen në njësitë përkatëse për zbatim **(Evidencë 1.15, Neni 20).**

Bordi i administrimit është organi më i lartë kolegjial administrativ. Mbledhjet në këtë organ thirren nga Kryetari. Anëtarët e Bordit të Administrimit marrin pjesë në diskutime dhe paraqesin mendimet dhe propozimet lidhur me çështjet, të cilat trajtohen në mbledhje. Mbledhjet e Bordit të Administrimit zhvillohen të mbyllura. Kryetari e jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim, rregulla këto të parashikuara shprehimisht në Rregulloren "Mbi organizimin dhe funksionin e Bordit të Administrimit", përkatësisht nenin 10 të kësaj Rregulloreje **(Evidencë 1.16, Neni 10).** Bordi mblidhet rregullisht 3 (tri) herë në një tremestër, dhe mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme **(Evidencë 1.16, Neni 8).**

Diskutimet e zhvilluara në mbledhjet e Bordit të Administrimit pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga mbajtësi i tij dhe Kryetari **(Evidencë 1.16, Neni 14).**

**Standardi I.6 Institucioni publikon veprimtarinë kryesore të organeve kolegjiale, raportin vjetor dhe aspekte të tjera të lidhura me transparencën.**

"Albanian University" harton raportin vjetor (**Evidencë 1.17),** në përputhje me Udhëzimin Nr. 5 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dt. 19.02.2018 për "Përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të Institucioneve të Arsimit të Lartë", dhe e miraton në një mbledhje të përbashkët midis Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit **(Evidencë 1.18)**. Në përputhje me Udhëzimin nr. 24, dt. 21.10.2019, Raporti Vjetor dërgohet zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në 1 kopje orgjinale të shkruar dhe/ose elektronike, brenda muajit Dhjetor të çdo viti **(Evidencë 1.19)** dhe më pas e bën publik në faqen e tij zyrtare (https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/).

Raporti paraqet interes jo vetëm për MAS, e cila verifikon përmbushjen e detyrimeve ligjore, por njëkohësisht edhe për të gjthë studentët e ardhshëm, duke i ofruar një panoramë të qartë që i vjen në ndihmë

atyre në zgjedhjet për të ardhmen e jetës universitare e më gjerë.

**Standardi I.7 Institucioni harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë në programe e studimit që ofron.**

Sigurimi i cilësisë është një proces i vazhdueshëm, konkretisht sigurimi i cilësisë së programeve të studimit fokusohet në tre nivele të rëndësishme:

- Në nivel institucional,
- Në nivel programi,
- Në nivel individual.

*Në nivel institucional,* fokusi vihet në hartimin e politikave mbështetëse dhe inkurajuese, si dhe nxitjen e njësive përgjegjëse në aplikimin, fitimin dhe më pas zbatimin e projekteve të ndryshme në shërbim të ngritjes së kapaciteteve për implementimin gjithmonë e më të mirë të programeve të studimit dhe në përshtatje me zhvillimet mësimdhënëse bashkëkohore sipas fushave përkatëse.

*Në nivel programi,* njësitë bazë përgjegjëse angazhohen në zbatimin e politikave mbështetëse dhe inkurajuese të hartuara në nivel Institucioni, duke i përshtatur ato me nevojat specifike tëprogrameve të studimit, në përputhje edhe me nevojat e tregut të evidentuara nga studimi i vazhdueshëm i tij. Njësitë bazë përgjegjëse për programet e studimit, luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e projekteve dhe zbatimin e tyre me qëllim rritjen e kapaciteteve.

*Në nivel individual,* mund të konsiderojmë së pari zhvillimin, trajnimin, motivimin dhe rritjenindividuale të stafit akademik duke rritur kështu cilësinë e mësimdhënies, por nga ana tjetër përfshin edhe nxitjen e studentëve dhe aktivizimin e tyre në veprimtari, të cilat mundësojnë fitimin e kompetencave në kuadër të programit të studimit dhe më gjerë **(Evidencë 1.20).**

Politikat e përmirësimit të cilësisë të programeve të studimit paraqiten në strategjinë e zhvillimit institucional **(Evidencë 1.6, fusha 4, fq. 17)**, si dhe në strategjinë e Sigurimit të Cilësisë së Institucionit **(Evidencë 1.20).**

Në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik njësia bazë harton raportin semestral **(Evidencë 1.21)** dhe raportin vjetor **( Evidencë 1.22),** në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen.

Zhvillimi i programeve të studimit në “Albanian University” është themel i procesit të sigurimit të cilësisë. Procesi konsiston në hartimin e një raporti vlerësues, i cili do të përfshijë të dhëna jo vetëm nga databasa e Departamentit, por nga gjithë personeli akademik, personeli ndihmës akademik, studentët aktual, alumni, si dhe tregu i punës **(Evidencë 1.17).**

**Standardi I.8 Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe të Institucionit.

Për të arritur objektivat formuese dhe rezultatet e synuara të të nxënit, Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit nëpërmjet:

- përcaktimit të kritereve dhe afateve të hartimit, riorganizmit dhe përmirësimit të programeve sipas

akteve ligjore dhe nënligjore;

- standardeve dhe kritereve të cilësisë së programeve të studimit bazuar në standardet në hapësirën europiane të arsimit të lartë (HEAL) dhe kodit të cilësisë;
- rishikimit të rregulloreve për secilin program studimi;
- rishikimit të kurrikulave në përputhje me nevojat e tregut dhe legjislacionin në fuqi, si dhe përditësimin e syllabuseve në përputhje me literaturën bashkëkohore dhe zhvillimet më të fundit në fushën përkatëse;
- ndërkombëtarizimit të programeve të studimit **(Evidencë R.10)**.

"Albanian University", përvec strukturave specifike për ruajtjen, përmirësimin dhe monitorimin e cilësisë ka ngritur edhe Grupet e Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti **(Evidencë 1.12.b)**. Këto janë grupe ad-hoc, të cilat përbëhen nga staf akademik i brendshëm i njësisë bazë, konkretisht 2 apo 3 pedagogë me tituj e me grada, të cilët punojnë për rishikimin e kurrikulave dhe syllabuseve, në bashkëpunim me lektorët e lëndëve, si dhe janë pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm në rastet e akreditimit të programeve të studimit.

**Standardi I.9 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës.**

Duke u bazuar në strategjinë kombëtare për zhvillim, bazuar në strategjinë e zhvillimit institucional 2017 - 2022, aktet ligjore në fuqi, nevojat dhe kërkesat e tregut, AU vlerëson dhe merr vendime për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit.

Grupi i Sigurimit të Cilësisë (GSC) në nivel departamenti, ndihmon në hartimin e raportit vjetor të vetëvlerësimit të programit të studimit, sipas formatit të dërguar nga NJSBC. Ky raport plotësohet nga çdo program studimi që ofrohet në "Albanin University" dhe bëhet pjesë e raporteve të njësive kryesore e më pas atij institucional, i cili bëhet publik në faqet zyrtare **(Evidencë 1.22), (Evidencë 1.23), (Evidencë 1.17).**

Departamenti vë në dispozicion të hartuesve të raportit:

Të dhëna mbi zbatimin e planit mësimor për vit akademik, programet lëndore dhe stafin akademik përkatës; Statistika të sekretarisë mësimore mbi regjistrimin e studentëve, progresin e tyre dhe % e kalueshmërisë; Përmbledhje e problematikave të rezultuara nga pyetësorët e studentëve **(Evidencë 1.24 a, b)** dhe fokus-grupeve **(Evidencë 1.25 a, b, c, d)**; Raportet e vetëvlerësimit të stafit akademik **(Evidencë 1.26)**; Raporti semestral dhe vjetor i Departamentit; Raportet e Vlerësimit të Brendshëm dhe të Jashtëm, si dhe rekomandimet e lëna nga Bordi i Akreditimit, ASCAL, (nëse programi i është nënshtruar procesit të vlerësimit periodik); Statistika të punësimit të Alumni; Studimi i tregut të punës **(Evidencë R.5)**.

**Standardi I.10 Institucioni përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Në "Albanian University" sigurimi i brendshëm i cilësisë i programeve të studimit realizohet nga NJSBC në bashkëpunim me njësitë e sigurimit të cilësisë të ngritura në nivel departamenti me pjesëmarrjen e stafit akademik **(Evidencë 1.9, neni 7).**

Për sigurimin e brendshëm të cilësisë të programeve të studimit përdoren instrumenta matës per ecurinë e programeve tw studiumit të tillë si: pyetësorë me studentët dhe stafin akademik dhe administrativ (respektivisht 2 dhe 1 herë në vit), fokus grupet e realizuara nga NJSBC **(Evidenca 1.24 a,b)**.

Pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, informacioni i dërgohet të gjitha instancave përkatëse, të cilat i diskutojnë në mbledhje të posatshme dhe ia komunikojnë në mënyrë konfidenciale grupeve të interesi. NJSBC publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë **(Evidenca 1.24.c)**.

Rezultatet e vlerësimeve të marra nga fokus grupet dokumentohen nga NJSBC në formë shkresore, i dërgohen çdo njësie bazë dhe Rektoratit me qëllim diskutimin në mbledhje të Senatit Akademik për përmirësime të mundshme në të ardhmen **(Evidencë 1.25 a ,b ,c, d)**.

**Standardi I.11 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

“Albanian University” synon të identifikohet si një Institucion i Arsimit të Lartë elitar në rajon e më gjerë duke u fokusuar te cilësia në çdo iniciativë akademike, duke bërë të mundur formimine “kulturës së cilësisë”.

NJSBC ka rol mbështetës, këshillimor, bashkërendues, monitorues e administrativ me strukturat e tjera akademike dhe administrative të universitetit, si dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë).

Qëllimi i procesit të sigurimit të cilësisë është të identifikojë sukseset dhe praktikat e mira të ndjekura gjatë vitit paraardhës, të cilat mund të ndahen në të gjithë institucionin, si dhe të identifikojë çështje që kërkojnë zgjidhje ose zhvillim të mëtejshëm **(Evidencë 1.27), (Evidencë 1.28).**

NJSBC harton një raport vjetor në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe Kërkimit Shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë. Raporti vjetor paraqitet fillimisht pranë Komisionit për Vlerësimin Institucional, i cili ja paraqet Senattit Akademik për ta përfshirë më pas në rendin e ditës të mbledhjës së radhës së tij.

**Përfundimi dhe Vlerësimi**

Institucioni, në bazë të Statutit, rregullores institucionale dhe akteve të tjera rregullatore që rrjedhin prej tyre, ka ngritur struktura për realizimin e misionit dhe objektivave të tij. Të gjitha strukturat e ngritura, përcaktojnë veprimtarinë e tyre, si dhe rregullojnë marrëdhënien me strukturat e tjera përmes rregulloreve përkatëse të miratuara në zbatim të Statutit të AU dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është një pikë kyçe në Institucion, e cila në përputhje me aktet ligjorë në fuqi, standardet shtetërore të cilësisë, si dhe manualin për “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit” të ASCAL, ushtron funksionin e saj duke siguruar të dhëna objektive dhe duke kontribuar në ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Institucion.

## II – BURIMET DHE PARTNERITETI

### Standardi II.1 Institucion ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekruktimit të burimeve njerëzore.

“Albanian University” (AU) ka strukturën e vetë Institucionale, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Organigrama bëhet publike në faqen e internetit të Universitetit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/struktura-institucionale/) **(Evidencë 2.1).** Kjo strukturë përcakton përgjegjësitë për administrimin e burimeve për të përmbushur kërkesat e Standardeve Shtetërore të Cilësisë.

“Albanian University” në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme, ndjek në mënyrë transparente të gjitha procedurat ligjore për rekrutimin e personelit akademik dhe administrativ **(Evidencë 2.2)**. Rekrutimi i stafit akademik në AU bazohet në respektim të kërkesave të kuadrit ligjor për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Kodin e Punës, si dhe në Statutin dhe Rregulloren e AU **( Evidencë 1.1 neni 36), (Evidencë 1.4).**

Njësitë Bazë, bazuar në nevojat për realizimin e procesit të mësimdhënies, propozojnë pranë Njësive Kryesore kriteret e konkurimit për personel akademik me kohë të plotë apo të pjesshme. Kriteret miratohen nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori i AU **(Evidencë 1.4, neni 30).**

Zyra e Burimeve Njerëzore publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion pune vakant në faqen zyrtare të Albanian University, si dhe në mjetet e tjera të informimit publik **(Evidencë 2.2)** (https://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-tek-fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike/ *)*

Në kuadër të mirëfunksionimit të procesit mësimor, njësitë bazë të AU kanë të drejtë të kërkojnë të punësojnë me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiues dhe/ose personalitete vendase ose të huaja, në fushat respektive të studimit në AU, bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 neni 62 **(Evidencë 2.3).**

### Standardi II.2 Institucion ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.

“Albanian University” ndjek një politikë integruese të të gjithë të punësuarve të tij, të personelit akademik, personelit ndihmës-akademik (me karakter mësimor dhe me karakter administrativ) dhe personelit administrativ.

Statuti **(Evidencë 1.1, neni 35)** përcakton se lektorët dhe kërkuesit shkencorë kanë autonomi dhe liri akademike të garantuar për mësimdhënie dhe punë kërkimore pa penguar arritjet e objektivave dhe programeve kurrikulare. Universiteti mbështet angazhimin e stafit në veprimtari të jashtme dhe u jep atyre të drejtën të kthehen më pas në vendin e tyre të punës **(Evidencë 2.4).** Në kuadër të integrimit dhe rritjes profesionale të personelit akademik dhe atij ndihmës-akademik, Institucioni organizon seminare, ditë informimi, aktivitete promovuese etj **(Evidencë 2.5 a.b)**.

Në fillim të vitit akademik, AU organizon javën orientuese për studentët e regjistruar në vitin e parë në programet e studimit *Bachelor* dhe Programet e Integruara *Master i Shkencave*, gjatë të cilës i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe ai administrativ janë të përfshirë në procesin e informimit të studentëve. Gjatë tyre, studentët informohen mbi programet e studimit, rregulloren përkatëse, të drejtat dhe detyrimet

e tyre, aktivitetet kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, mundësitë e mobiliteteve Erasmus+, zyrat në mbështetje të tyre etj.

(https://albanianuniversity.edu.al/sq/axhenda-e-javes-orientuese-per-vitin-akademik-2020-2021/ )

**(Evidencë 2.6).** Këto Ditë Informimi realizohen përmes prezantimeve nga përgjegjësit e departamenteve dhe anëtarët e stafit/personelit akademik dhe atij me karakter administrativ **(Evidencë 2.7)**. AU përgatit broshurat për informimin e studentëve **(Evidencë 2.8)** (https://albanianuniversity.edu.al/sq/broshura-per-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve/)
AU merr pjesë gjithashtu, në Ditët e Informimit të Maturantëve të organizuara nga MAS me qëllim informimin e matuarantëve (kandidatëve për studentë) mbi programet e studimit që ofron. Gjatë vitit akademik 2021 – 2022, këto takime u organizuan online nëpërmjet platformës Microsoft Teams kushtëzuar nga pandemia Covid-19. **(Evidencë 2.7)** (https://albanianuniversity.edu.al/sq/albanian-university-nis-fushaten-promovuese-te-universitetit-per-vitin-akademik-2022-2023/). Informimi realizohet përmes broshurave **(Evidencë 2.8)**, si dhe takimeve të organizuara me maturantët (https://albanianuniversity.edu.al/sq/dita-orientuese-mbi-programet-e-ofruara-nga-departamenti-i-inxhinierive-albanian-university/). AU është pjesë edhe e panaireve të ndryshme që kanë në fokus promovimin e tij **(Evidencë 2.9)** (https://albanianuniversity.edu.al/sq/panairi-work-and-study-shtator-2020/ )
AU ndjek dhe përkrah integrimin e personelit në jetën e tij sociale. Au nxit dhe inkurajon pjesëtarët e stafit të bëhen pjesë e aktiviteteve të ndryshme me karakter argëtues, informues, letrar, sportiv të organizuara nga institucioni apo institucione të tjera me të cilat AU bashkëpunon **(Evidencë 2.10)**.

**Standardi II.3 Institucion ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij dhe fokusohet në zhvillimin e mëtejshëm të tyre.**

Universiteti organizon trajnime si për stafin akademik, ashtu edhe për atë administrativ, sipas përparësive të Universitetit **(Evidencë 2.11), (Evidencë 2.5 a,b).**

Njësitë Bazë në fund të çdo viti akademik realizojnë një vlerësim për punën dhe performancën e çdo anëtari të stafit/personelit akademik **(Evidencë 2.12).** Një element i rëndësishëm për vlerësimin e aftësive të stafit akademik dhe administrativ janë edhe pyetësorët e studentëve, të cilët realizohen dy herë në vit **(Evidencë 1.24 a,b)**. Risi ka qenë dhe pyetësori i lumturisë, i cili kërkon të marrë një informacion mbi kënaqësinë në punë të stafit të angazhuar në AU **(Evidencë 2.13)**.

AU mbështet kualifikimin e stafit/personelit duke ofruar programe studimi të Ciklit të tretë, specializime afatgjata në Stomatologji, si dhe bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka me universitete të huaja ka Doktoruar studentë të tij të ekselencës **(Evidencë 2.14)**. Bazuar në këto marrëveshje bashkëpunimi me Universitetet partnere të huaja, si dhe qendra kërkimore brenda dhe jashtë vendit **(Evidencë 2.15)**, me angazhimin e stafit/personelit akademik të përbashkët, AU është angazhuar në riorganizimin e programeve Doktoratë dhe hapjen e programeve të reja (https://albanianuniversity.edu.al/sq/doktoratura/).

AU mbështet mobilitetin e personelit akademik me qëllim kualifikimin e tij bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit me IAL-të në Europë, programit Erasmus +, si dhe në shkëmbimin e përvojës nëpërmjet pjesëmarrjes së pedagogëve të huaj, si lektorë pranë AU, në leksione të hapura, workshope, konferenca shkencore me qëllim rritjen e kapaciteteve akademike dhe nivelin e ekspertizës së AU **(Evidencë 2.3).**

**Standardi II.4 Institucioni ndjek një politikë të zhvillimit social.**

Krahas angazhimit në jetën akademike dhe kërkimore shkencore, personeli i AU është përfshirë edhe në aktivitete të tjera me karakter social, ku ai jep kontributin e vet në shoqëri dhe komunitet **(Evidencë 2.10)**. Në këtë kuadër, vlen të përmenden si shembuj të praktikës së mirë edhe bashkëpunimet me organizata si

Kryqi i Kuq Shqiptar **(Evidencë 2.16)**, Klinikën Universitare “Nënë Tereza” apo Shoqata e psikologëve **(Evidencë 2.17)** (promovimi i shëndetit oral, gratë e dhunuara etj.). Universiteti, gjithashtu, promovon dialogun duke përfshirë stafin në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe konsultimit **( Evidencë 2.18).**

AU në kuadër të politikave të zhvillimit social, gjatë vitit akademik 2021 - 2022 ka organizuar edhe një pyetësor për stafin akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ **(Evidencë 2.19 a.b.c.d).**

Në funksion të zhvillimit të një politike sociale, AU e trajton marrëdhënien e punës së çdo anëtari të stafit/personelit të saj, si një të drejtë sociale, nga e cila burojnë të drejtat e tjera – ato për sigurimin e jetës dhe të shëndetit. Nisur nga kjo, çdo kontratë pune është e deklaruar pranë organeve shtetërore përkatëse, dhe çdo person i punësuar në AU, përfiton në bazë të ligjit Nr. 7703/1993, ndryshuar “Për sigurimet shoqërore në R.SH” të drejtat që rrjedhin nga ky ligj, parashikuar shprehimisht në kontratën individuale të punës **(Evidencë 2.20 a, b, c).**

### Standardi II.5 Institucioni siguron qëndrueshmëri afatgjatë të personelit akademik gjatë periudhës midis dy akreditimeve.

AU bazuar në politikat e zhvillimit Institucional dhe në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të parametrave të cilësisë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë qëndrueshmërisë së personelit akademik. Stafi akademik pajiset me kontratw pune si staf akademik me kohë të plotë (PAE) si dhe me Kontratë (PAK) në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015 si dhe Kodin e Punës, në Republikën e Shqipërisë. Nw pwrmbajtje te kontratave parashikohet e drejta e stafit me kohë të plotë për të kërkuar një financim nga Albanian University për një aktivitet shkencor brenda ose jashtë vendit ose botim shkencor në fushën që përbën prioritet për njësinë bazë përkatëse **(Evidencë 2.20.a), (Evidencë 2.21)** si dhe e drejta e shkëputjes nga angazhimet e institucionit për kryerjen e vitit sabatik një herë në shtatë vjet me miratimin e njësisë bazë, për periudha kohore deri në një vit, për të punuar për përparimin akademik **(Evidencë 2.4).**

Me qëllim kualifikimin dhe motivimin e mëtejshëm të stafit akademik wshtw rritur numri i mobiliteteve per stafin e Albanian University pranë Universiteteve të huaja dhe anasjelltas bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit dhe marrwveshjet Erasmus që Albanian University ka me këto Institucione **(Evidenca R.19).** Institucioni realizon një pyetësor drejtuar personelit akademik të AU me qëllim marrjen e feedback-ut në lidhje me eksperiencën e tij në Albanian University, duke u fokusuar në çështje të tilla si: aspekti personal, paga dhe kushtet, politikat e universitetit, ambjenti i punës, mësimdhënia, institucioni, studentët dhe departamenti, puna kërkimore – shkencore, etj. Rezultatet e pyetësorit mbështesin analizën e qëndrueshmërisë në punë të stafit **(Evidencës 2.13).**

Albanian University ka realizuar një analizë mbi qëndrueshmërinë e stafit të angazhuar pranë tij, bazuar në fillimin dhe kohëzgjatjen e bashkëpunimit me të dhe në bazë të kësaj analize rezultati tregon për një qëndrueshmëri të stafit. Për më shumë informacion bashkëngjitur gjeni analizën statistikore **(Evidenca 2.22).**

### Standardi II.6 Institucioni vlerëson dhe mbështet personelin e vet në përmbushjen e detyrimeve vjetore-akademike e administrative.

Vlerësimi i personelit akademik në “Albanian University”, bazohet në kriteret e mëposhtme:

- **Vlerësimi nga drejtuesi i departamentit (Evidencë 2.12)** – çdo fund semestri drejtuesi i Njësisë Bazë, harton një raport përmbledhës për secilin pedagog, në të cilin konsiderohen: vlerësimi mesatar i marrë nga pyetësorët drejtuar studentëve, vlerësimi mbi korrektësinë e realizimit të orëve të mësimit përmes raportit semestral të plotësuar nga pedagogët **(Evidencë 1.26)**, vlerësimi i drejtuesit të departamentit mbi angazhimin në çështjet administrative të departamentit, mbi veprimtarinë kërkimore - shkencore dhe trajnimet e pedagogut, bazuar në vetë - deklarimet e tyre përmes formularit të veprimtarisë kërkimore – shkencore.

- **Vlerësim nga studentët** nëpërmjet pyetësorëve, 2 herë në vit, një në përfundim të semestrit të parë dhe një në përfundim të semestrit të dytë **(Evidencë 1.24 a,b),** gjithmonë përpara sezonit të provimeve, dhe fokus grupeve që organizohen nga NJSBC sipas axhendës së tyre **(Evidencë 1.25 a,b,c,d).**

Mbështetja e AU për përmbushjen e detyrimeve vjetore akademike konsiston në përkrahjen e stafit me pjesmarrje në konferenca kombëtare apo ndërkombëtare të organizuara nga ai vetë ose nga universitete partnere, realizimi i botimeve akademike në Revistën Shkencore "Optime", e cila gjendet në formatin online (https://www.albanica.al/index.php/optime) **(Evidencë 2.23)** dhe në linkun e Universitetit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/revista-optime/) (**Evidencë 2.24**).

1. Organizimi i konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me universitete të njohura në Europë, ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe jane botuar në përmbledhjen e abstrakteve apo "Proceedings" me numër ISBN-je **(Evidencë 2.25).** Gjithashtu, konferencat e organizuara në fushën e mjekësisë janë akredituar për profesionistët nga vetë Institucioni i cili prej 4 vitesh gëzon këtë privilegj nga autorizimi i Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim (QKEV) **(Evidencë 2.26).**
2. Promovimi i anëtarëve të stafit akademik, nëpërmjet mbështetjes financiare në aktivitete të ndryshme shkencore: konferenca, simpoziume, kongrese të organizuara në AU apo jashtë vendit **(Evidencë 2.27).**
3. Publikimi i Revistës shkencore "Optime", 2 herë në vit ku anëtarët e stafit akademik, kanë mundësi që në funksion të rritjes së nivelit të tyre akademik, të publikojnë në këtë revistë pasi kalojnë në një proces recensimi për garantimin e cilësisë së punimeve shkencore **(Evidencë 2.28)**.
4. Mbështetja financiare nga ana e AU, për botimin e teksteve të ndryshme mësimore, në formën e librave apo leksioneve të shkruara **(Evidencë 2.29).**
5. Promovimi i anëtarëve të stafit akademik, nëpërmjet një sistemi të diferencuar në pagë, në funksion të titujve dhe gradave shkencore që ata kanë, si dhe bazuar në kontributin që ata japin në Institucion **(Evidencë 2.20 a,b,c).**

**Standardi II.7 Institucioni disponon dhe menaxhon pasuritë e paluajtshme dhe fokusohet në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.**

Një nga veçoritë e AU është pozicioni i saj në qendër të kryeqytetit në godina, të cilat mbartin vlera kultorore dhe historike. Institucioni ka një evidencë të pasurive të paluajtshme të tij, bazuar këto në kontrata përdorimi – qiraje afatgjata **(Evidencë 2.30 a,b,c,d,e,f,g,h,i).**

AU në funksion të procesit mësimor për vitin akademik 2021-2022, ka në administrim 5 (pesë) godina:

Godina 1 (Bulevardi Zogu I, ish-Estrada) me 4 kate, me sipërfaqe totale 3.996 $m^2$. Godina 2 (Rruga e Durrësit, ish Gjykata) me 4 kate, me sipërfaqe totale 2.267 $m^2$.

Godina 3 (Rruga K. Karafili - Internacionali) me 5 kate, me sipërfaqe totale 1.835 $m^2$.

Godina 4 (Rruga e Kavajës – FSHAE) me 6 kate, me sipërfaqe totale 1.902 $m^2$.

Godina 5 (Klinika Rruga e Kavajës – FSHM) 1 kat, me sipërfaqe totale 500 $m^2$.**(Evidencë 2.31)**

"Albanian University", si pjesë e Shoqërisë tregtare UFO shpk, ka një masterplan për sigurinë, rehabilitimin, zgjerimin, dhe/ose ristrukturimin e pasurive të paluajtshme të tij. Në kuadër të zgjerimit të tij, në territorin e selisë qendrore të universitetit, pritet të miratohet ndërtimi i një strukture të

re moderne, që do i shërbejë universitetit, në kuadër të planit urbanistik të bashkisë Tiranë.
AU menaxhon asetet e tij sipas një plani të përcaktuar, që synon përmirësimin e cilësisë së ambienteve mësimore dhe shkencore, të pasqyruar edhe në buxhetin e përvitshëm të Institucionit të paraqitur pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

**Standardi II.8 Institucioni siguron infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore.**

Infrastruktura e universitetit ofron kushte të përshtatshme dhe bashkëkohore për realizimin e veprimtarisë së përditshme akademike dhe administrative si: ambiente për personelin akademik, ambiente për personelin administrativ, sekretarinë mësimore, salla leksionesh, seminaresh, ambiente për laboratorë, Senatin Akademik, salla të pajisura me projektorë, salla kompjuterësh, salla për konferenca, ambiente për bibliotekën, mjedise shërbimi për të tretë, mjedise sportive etj. **(Evidencë 2.32).**
AU disponon mjedise në dispozicion të veprimtarisë së personelit akademik, në përpjesëtim me numrin e tij, në mënyrë që secili nga anëtarët e stafit të ketë vendin e tij të punës në një zyrë apo mjedise të përshtatshme për të zhvilluar aktivitetin shkencor dhe mësimor.

AU ushtron veprimtarinë e tij në objekte të rindërtuara dhe rivlerësuara me materiale cilësore bashkëkohore, të shfrytëzueshme tërësisht vetëm për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, si dhe administratën dhe plotësojnë tërësisht nevojat higjieno-sanitare duke shmangur elementet e rrezikshmërisë **(Evidencë 2.33 a,b,c,d).**

AU është larg zonave të zhvillimit industrial apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara sipas standardeve përkatëse. Korpuset ndodhen në zonën e qendrës së Tiranës, dhe shumë pranë ndërtesave të karakterit rezidencial apo të shërbimeve të tjera për studentët.

Institucioni plotëson normativën e sipërfaqes shfrytëzuese të përcaktuar për çdo student, duke iu referuar këtu edhe kuotave të miratuara nga MAS **(Evidencë 2.34).**

Au garanton kapacitet e nevojshme për formimin praktik të studentëve në programet e studimit të Stomatologjise, Farmacisë, Inxhinierisë dhe Mësuesisë **(Evidencë 2.35).**

**Standardi II.9 Institucioni siguron mjedise komode pune - mësimore - laboratorike të përshtatshme për personelin akademik dhe studentët dhe personat me aftësi të kufizuara.**

AU ndjek një politikë mbështetëse për studentët me aftësi ndryshe. Ndjekja e procesit mësimor merr një vëmendje të veçantë në aspektin e mbështetjes dhe lehtësimit të procesit të të nxënit dhe qëndrimit në klasë **(Evidencë 2.36).**

Institucioni i kushton rëndësi të vazhdueshme mbështetjes së kategorive sociale dhe bursave të studimit, si pjesë e përgjegjësisë ndaj komunitetit.

Kategoritë e bursave që ofrohen nga "Albanian University" janë edhe bursa për studentë me aftësi të kufizuara **(Evidencë 2.37).**

Edhe pse jo të gjitha godinat janë të pajisura me ashensor ose rampa, kjo situatë pritet të zgjidhet me kampusin e ri për të cilin Insittucioni është në pritje të lejes së ndërtimit.

**Standardi II.10 Për programet e studimit të fushave mjekësore, inxhinierike institucioni siguron laboratorë të standarteve të larta profesionale e shkencore.**

Institucioni, vë në dispozicion të programeve të studimit të ofruara një sërë laboratorësh mësimorë**.** Për programet e ofruara nga Departamenti i Art Dizajnit, Departamenti i Inxhinierive dhe Fakulteti i

Shkencave Mjekësore, Institucioni siguron infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e laboratoreve, praktikave mësimore/profesionale dhe seminareve/ushtrimeve **(Evidencë 1.17).**

Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike. Punët laboratorike, kryhen në prani të pedagogut të laboratoreve dhe laborantit (në funksion të tipologjisë së laboratoreve), për një mbarëvajtje sa më të mirë të tyre.

Pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore, në kuadër të programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Stomatologji" dhe Specializimeve afatgjata në fushën e Stomatologjisë, funksionon edhe Klinika Universitare Stomatologjike "Çerçiz Mingomataj", e cila është akredituar nga Ministria e Shëndetësisë **(Evidencë 2.38)** (https://albanianuniversity.edu.al/sq/klinika-universitare-2/) .

Gjithashtu, pranë këtij fakulteti është ngritur Klinika e Fizioterapisë, e cila ju vjen në ndihmë studentëve të programit të studimit *Bachelor* në "Fizioterapi" (https://albanianuniversity.edu.al/sq/klinika-e-fizioterapise/). Praktikat mësimore/profesionale realizohen në bashkëpunim me institucione/kompani/organizata me të cilat "Albanian University" ka marrëveshje bashkëpunimi dhe nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga departamenti, i cili mbikqyr realizimin e praktikës nga ana e studentit (**Evidencë 2.39)**, (**Evidencë 2.40).**

AU për të gjitha programet e studimit, të cilat kanë pjesë të kurrikulës formimin praktik të studentëve garanton kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e tyre. Për këtë janë bërë marrëveshje institucionale për praktikat e studentëve me institucione shtetërore dhe private, si Arkiva e Përgjithshme e Shtetit, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë, Bashkia Tiranë, Agjencia e Shërbimit të Sportit, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" etj. **(Evidencë 2.41).**

Institucioni në të tre fakultetet ofron biblioteka me infrastrukturë të përshtatshme për studentët, të pasur me literaturë bashkëkohore, si dhe mundësi aksesi në libraritë *online* **(Evidencë 2.42.a.b).**

**Standardi II.11 Institucioni siguron mjedise të përshtatshme pushimi, sportive dhe argëtimi për personelin akademik dhe studentët e vet.**

Në kuadër të bashkëpunimit që Universiteti ka me "Albanian College" në Tiranë, studentët e AU shfrytëzojnë hapësirat sportive (fushë basketbolli, volejbolli, tenis, palestër etj.) të këtij kolegji për aktivitete/kampionate të ndryshme që zhvillohen gjatë vitit **(Evidencë 2.43).**

**Standardi II.12 Institucioni monitoron në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e infrastrukturës fizike dhe angazhohet në përmirësimin e saj.**

AU ushtron veprimtarinë e tij në pesë objekte të rindërtuara dhe rivlerësuara me materiale cilësore bashkëkohore, të shfrytëzueshme tërësisht vetëm për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, si dhe administratën dhe plotësojnë tërësisht nevojat higjieno-sanitare duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. AU ka ngritur grupet e punës për mirëmbajten e godinave **(Evidencë 2.44).**

Pjesa më e madhe e godinave janë të termoizoluara; shumica e dritareve të institucionit janë me dopio-xham jo vetëm për të siguruar temperatura të brendshme të qëndrueshme por gjithashtu, për të evituar zhurmat nga jashtë. Institucioni në mënyrë të vazhdueshme mirëmban dhe rikonstrukton ambientet, të cilat shfaqin problematika në lidhje me izolimin për të shmangur lagështirën dhe jo vetëm.

Infrastruktura e Universitetit disponon të gjithë elementet e nevojshëm mësimore-shkencore universitare, si: ambiente për personelin akademik të pajisura me kompjutera, internet dhe të gjitha pajisjet e nevojshme; ambiente për personelin administrativ, klasa me hapësira të mëdha, të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, ambiente për laboratorë të programeve të ndryshme të studimit, ambiente për bibliotekën, senatin akademik, salla audiovizive, salla kompjuterash, salla për konferenca etj **(Evidencë 2.31).**

Për programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Art Dizajnit, Departamenti i Inxhinierive dhe

Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Institucioni siguron infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e laboratoreve, praktikave mësimore/profesionale dhe seminareve/ushtrimeve **(Evidencë 2.35).**

**Standardi II.13 Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.**

Universiteti ka një trashëgimi akademike dhe kulturore dhe arkivon botimet e stafit akademik dhe tezat e doktoratës dhe diplomës të hartuara nga studentët, duke i ruajtur ato në bibliotekat e çdo fakulteti. Gjithashtu, AU ka dhe shtypshkronjën e saj AU-Press.

Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga AU kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

AU ka si strukturë përgjegjëse Zyrën e Arshivës dhe Protokollit, për ruajtjen e dokumentacionit të të gjitha veprimtarive të rëndësishme të institucionit, sipas rregullores përkatëse.

Dokumentacioni ruhet dhe mirëmbahet në letër (*hardcopy*) dhe në version elektronik.

AU disponon bazë të dhënash në lidhje me regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit, të dhënat personale, etj. në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe duke respektuar kuotat dhe kriteret e përcaktuara nga vetë Universiteti dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për programet e studimeve që ofron **(Evidencë 2.34).**

Këto të dhëna janë të depozituara në strukturat përkatëse duke nisur me "Zyrën e Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve", Sekretaritë dhe Kryesekretaritë e Fakulteteteve, si dhe zyra e Administratorit të përgjithshëm.

Procesi i informimit dhe regjistrimit të studentëve të rinj realizohet nga Zyra e Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve, si dhe sekretaritë dhe Kryesekretaret. Informacioni, për kriteret dhe procedurën e aplikimit gjithashtu, mund të merret edhe *online* në faqen zyrtare, si dhe në broshurat informuese që përmbajnë të gjitha programet e studimit.
Kriteret dhe procedurat e hollësishme të transferimeve përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të AU, në Rregulloren e Regjistrimeve dhe Trasferimeve, si dhe në Rregulloret e programeve të studimit **(Evidencë 2.45).**

Institucioni disponon të dhëna të përgjithshme për programin, formën, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve.

Pranë Zyrës së Kryesekretareve të Fakulteteve gjenden për çdo program studimi në formë të shkruar dhe elektronike:

1. regjistrat themeltarë, në të cilat pasqyrohen, të dhënat personale të studentëve, numra matrikullimi, formën e studimeve, të dhëna për studimet e mëparshme, dhe ecurinë nga data e regjistrimit deri në diplomim të studentit **(Evidencë 2.46);**
2. regjistrat e arritjeve akademike të fituara nga studenti gjatë kohës së studimeve **(Evidencë 2.47);**
3. fletët e Provimit.

Administratori i Përgjithshëm i Universitetit është struktura përgjegjëse për përpunimin dhe nxjerrjen e statistikave, qofshin këto vjetore apo ndër vite, sipas kërkesave të Institucionit dhe MAS.

Informacioni fillestar për mbledhjen e statistikave vjen nga sekretaria mësimore. Administratori i

përgjithshëm:

1. Mban ndër vite të dokumentuara të dhëna të detajuara për studentët e regjistruar, studentët e transferuar, studentë të huaj, studentë të mbetur në stazh, studentë të larguar dhe studentë që janë diplomuar për çdo program studimi;

2. Harton dhe ruan regjistrat e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, si dhe protokollin hyrës dhe dalës;

3. Lëshon diplomat të shoqëruara me suplement dhe listë notash.

Informacioni mbi veprimtarinë akademike të studentëve ofrohet edhe në formë elektronike nëpërmjet sekretarisë *online* (https://au.pitagora.rash.al/).
Diplomat dhe suplementet shpërndahen vetëm në formën e shkruar. Suplementi i diplomës është në dy gjuhë **(Evidencë 2.48 a.b).**

**Standardi II.14 Institucioni ve në përdorim sisteme të informimit dhe të menaxhimi në nivel institucional.**

Strukturat përgjegjëse të ngarkuara me administrimin e sistemit të informacionit janë: Zyra e Informacionit, Zyra e IT dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë **(Evidencë 2.49 a.b.c).**
Të gjitha zyrat e AU janë përgjegjëse për të dhënë informacion të detajuar për Institucionin, duke ruajtur konfidencialitetin për çështje specifike. Midis vetë strukturave të Universitetit përdoret edhe intraneti.
Qëllimi i sistemit të informacionit është mbështetja, koordinimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve dhe punës së stafit/personelit akademik, stafit/personelit ndihmës-akademik, dhe studentëve nëpërmjet gamës së faciliteteve të mbështetura në internet si: laboratorët, arkiva elektronike, sekretaria *online*, *webmail* etj. Platforma Microsoft Teams është një mënyrë shumë e mirë për komunikimin e brendshëm të të gjithë hallkave të Institucionit.
Sistemi i informimit *online* ose sekretaria *online* ju jep mundësinë studentëve të logohen në kohe reale, nëpërmjet internetit, kudo që ata ndodhen. Secili prej studenteve ka llogarinë e tij, ku mund të logohet me kredencialet e tij dhe të marrë informacionin personal në lidhje me të dhënat e tij të përditësuara, rezultatet e arritura, lëndët, të cilat duhet të frekuentojë. Linku për t'u loguar është (https://au.pitagora.rash.al/) .

AU ka faqen e saj zyrtare (www.albanianuniversity.edu.al), e cila është e mirë organizuar dhe ofron informacione të nevojshme si për publikun e gjerë, ashtu dhe për studentët dhe personelin akademik si: kalendarin akademik vjetor, oraret mësimore, oraret e sesioneve të provimeve, aktivitetet, takimet dhe mbledhjet e punës, eventet sociale, raportet e vetëvlerësimit, oferta akademike, statutin, strukturën organizative, rregulloren e funksionimit të faqes *web* etj. **(Evidencë 2.50).**

**Standardi II.15 Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit.**

AU gjatë periudhës së pandemisë (v.a 2019 - 2020 (Sem. II) dhe v.a 2020 - 2021), gjatë së cilës u kalua në mësimdhënien *online*, në kohë të shkurtër vuri në përdorim të studentëve dhe stafit të tij akademik dhe administrativ, platformën e mësimdhënies *online* Microsoft Teams, si pjesë e paketës Office 365, e disponueshme për të gjithë përmes emaileve zyrtare të Institucionit **(Evidencë 2.51)**.

Kjo platformë ka ndihmuar institucionin gjatw kohws sw pandemisw dhe jo vetwm, pwr realizimin e procesit akademik dhe atij shkencor.

Më poshtë jepen disa aktivitete të zhvilluara *online* gjatë kësaj periudhe:

- Java informuese e projektit GRADUA (https://albanianuniversity.edu.al/sq/java-informuese-gradua-21-25-qershor/)
- Konferenca e XV Studentore Stomatologjike (https://albanianuniversity.edu.al/sq/konferenca-e-15-te-studentore-stomatologjike-me-teme-shendeti-oral-ne-udhekryq-sfida-te-reja-ne-eren-e-covid-19/)
- Konferenca Kombëtare "Implementimet Menaxheriale në Modelet e reja të të bërit Biznes" (https://albanianuniversity.edu.al/sq/implementimet-menaxheriale-ne-modelet-e-reja-te-te-berit-biznes/ )

AU është plotësisht i informatizuar me instalimet e IT në të gjitha godinat e tij. Institucioni disponon dhe vë në funksion të punës së pavarur të pedagogëve dhe studentëve me orar të zgjatur ambjente pune dhe laboratore informatike.

Sallat mësimore janë të pajisura me mjete audiovizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit; në dispozicion janë 4 laboratorë informatike.

Biblioteka është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë *online*. Mjediset e AU mbulohen me sinjal wi-fi. Laboratorët janë të pajisur me *software*-t përkatës.

Videokasetat dhe CD janë pjesë e zhvillimit të orëve të ndryshme mësimore; pedagogët/personeli akademik përdorin filma dhe dokumentarë si pikënisje të debateve dhe diskutimeve për një temë mësimore.

**Standardi II.16 Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe transparente.**

AU si pjesë e shoqërisë UFO shpk, i akordohet një buxhet vjetor në përputhje me nevojat bazuar në programin financiar (program financiar afatmesëm 3-vjeçar) **(Evidencë R.16).**
Programi financiar miratohet nga Bordi i Administrimit pasi hartohet nga Rektorati, si dhe pasi është bërë objekt diskutimi në Senat Akademik **(Evidencë 2.52).**

Krijimi dhe përdorimi i burimeve financiare në AU bëhet në bazë të një Programi financiar afat-mesëm 3-vjeçar, i hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara në Ligjin Nr. 80/2015, në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Struktura e programit financiar është bërë duke i ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet sipas drejtimeve në të cilin ato do të përdoren **(Evidencë R.16).**

**Standardi II.17 Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare.**

Institucioni siguron mjetet e nevojshme për zbatimin e politikave financiare, të parashikuara në programin financiar. Për këtë qëllim në strukturën organizative të AU është ngritur dhe funksionon një strukturë e posaçme, që krahas detyrave të tjera ushtron edhe atë për hartimin dhe zbatimin e Programit Financiar (**Evidencë 2.53).**

Burimet financiare të Institucionit janë hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe shkencore të AU, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së tyre. Procesi i hartimit të programi financiar fillon në muajin Shtator dhe miratohet në organet përkatëse brenda muajit Dhjetor të vitit paraardhës financiar.

Situata financiare e këtij Institucioni është e qëndrueshme nga fillimi i tij dhe premton një të ardhme të

kënaqshme e të qëndrueshme.
Si gjatë hartimit të Programit financiar, edhe gjatë zbatimit të tij në AU zbatohen rregullat e Ligjit për kontabilitetin, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në zbatim të tij dhe të gjitha rregullat e tjera financiare-fiskale, sipas ligjeve dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

**Standardi II.18 Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar.**

Veprimtaria financiare e AU është objekt i Auditorëve Ligjorë të Pasqyrave Financiare, në përputhje me Ligjin për kontabilitetin dhe kërkesave ndërkombëtare të Auditimit të raportimit Financiar. Që me miratimin e Statutit të ristrukturuar sipas Ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Republikën e Shqipërisë, në AU funksionon edhe zyra e Auditit të brendshëm.

Pasqyrat Financiare të Institucionit bëhen publike çdo vit, së bashku me raportin e Auditit Ligjor, në përputhje me ligjin për Kontabilitetin dhe Ligjin për QKB.
Pas analizave dhe diskutimeve në strukturat përkatëse të AU, raporti i veprimtarisë financiare pasi hartohet nga Rektorati diskutohet në mbledhjet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit **(Evidencë 2.54)**.

**Standardi II.19 Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.**

AU ka ndjekur dhe vazhdon të ndjekë një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Një gjë e tillë është e shprehur edhe në strategjinë institucionale për zhvillim, por njëkohësisht AU ka hartuar edhe Strategjinë “Për Partneritetin dhe Komunikimin”, në të cilën janë të përcaktuara prioritetet e politikës së bashkëpunimit **(Evidencë 2.55).** Në këtë kuadër AU ka vendosur partneritete me institucione arsimore dhe kërkimore shkencore me qëllim bashkëpunimin në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve të nevojshme duke promovuar iniciativat shkencore dhe të shkëmbimit kulturor. Nisur nga kjo AU ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me Institucione të Arsimit të Lartë vendase dhe të huaja **(Evidencë 2.56 a.b).**

Në planin Strategjik të Institucionit përcaktohen,cilësia e lartë në menaxhim, kërkim dhe zhvillim, me qëllim krijimin e një komuniteti kombëtar, rajonal e më gjerë, i cili bazohet në një zhvillim të qëndrueshëm. Ky zhvillim në bazë të strategjisë mund të realizohet më së miri në sajë të një bashkëpunimi të vazhdueshëm, i cili konsiston në këmbimin e eksperiencave në të gjitha format e veta midis Institucioneve të Arsimit të Lartë Kombëtar dhe Ndërkombëtar.

Strategjia për kërkimin shkencor në “Albanian University” bazohet në Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022, si dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional të Albanian University 2017 – 2022 **(Evidencë 1.6)**. Institucioni synon të identifikohet, ashtu si dhe në mësimdhënie, si një institucion elitar në kërkimin shkencor në Shqipëri dhe rajon, përmes zbatimit të projekteve kërkimore – shkencore të avancuara në fushat e studimit që ofron, duke dhënë një kontribut në zhvillimin social – ekonomik, shëndetësor dhe teknologjik të vendit **(Evidencë R.9).**

**Standardi II.20 Institucioni bashkëpunon me institucionet të tjera në mbështetëtje të veprimtarisë së tij akademike, administrative, kërkimore-shkencore/artisike dhe praktikave profesionale.**

AU bashkëpunon me Institucione vendase dhe të huaja të Arsimit të Lartë në kuadër të kërkimit shkencor **(Evidencë 2.56 a,b).** Bashkëpunimet janë në zgjerim të vazhdueshëm. Përmes tyre është mundësuar pjesëmarrja/aplikimi në projekte në programe të ndryshme europiane të kërkimit shkencor dhe mobilitetit (Erasmus+, CEEPUS, Horizon, COST, etj.).

AU ka një sërë bashkëpunimesh me institucione vendase dhe të huaja, të cilat mundësojnë

mobilitetet e stafit akademik dhe atij administrativ, me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, si dhe aktivitete të tjera ekstrakurrikulare **(Evidencë 2.57).**

AU ka fituar disa projekte të listuara më poshtë dhe është në proces të zbatimit të tyre:

1. Projekti GRADUA (https://albanianuniversity.edu.al/sq/gradua-2/) **(Evidencë R.13.a),**

2. Projekti me Arkivat e Shtetit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/ceremonia-e-dhenies-se-certifikatave-studenteve-te-fakultetit-te-shkencave-shoqerore/) **(Evidencë R.13.b)**.

3. Projekti me Kuvendin e Shqipërisë (https://albanianuniversity.edu.al/sq/konference-shkencore-nderkombetare-me-rastin-e-100-vjetorit-te-miratimit-te-rregullores-se-pare-te-kuvendit-te-shqiperise/) **(Evidencë R.13.c)**

4. Projekti "Disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme" **(Evidencë R.13.d),**

5. Projekti RESILIENCE (https://albanianuniversity.edu.al/sq/resilience-2/) **(Evidencë R.13.e)**

6. CEI extraordinary Call "Distance learning on epidemic and pandemic outbreaks in Western Balkans" (ref. n. 305.1521-20)

7. "Support to enhance the organisation and governance of the Institute, strengthen its capacity for data collection, epidemiological analysis, and monitoring, and improve its emergency response for communicable diseases and cross-national threats" Twinning Reference Number: AL 20 IPA HE 01 21 TWL EuropeAid/172817/ID/ACT/AL.

8. Projekti "Innovation Eco-system to Accelerate the Industrial Uptake of Advanced Surface Nano-Technologies" (https://www.newskin-oitb.eu/), i cili zbatohet në kuadër të Qendrës "Albanian University Center" (https://albanianuniversity.edu.al/sq/au-center/) , etj.

AU ka aplikuar në një sërë projektesh, të cilat i ka fituar dhe disa janë në proces vlerësimi **(Evidencë R.12).**

AU bashkëpunon me kompani të ndryshme publike dhe private për realizimin me sukses të praktikave mësimore/profesionale të studentëve të tij **(Evidencë 2.58).**
AU, për plotësimin e nevojave të veta në funksion të realizimit sa më cilësor të programeve të studimeve ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me IAL vendase dhe të huaja, si dhe Institucione të tjera publike e private, biznese, etj.

**Standardi II.21 Institucioni ndjek politika favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar.**

Personeli akademik i AU merr pjesë në aktivitete ndërkombëtare, në konferenca, simpoziume, *workshope*, si dhe organizon vetë aktivitete ndërkombëtare, si p.sh. konferenca shkencore, simpoziume, etj. **(Evidencë 2.59)**

AU bazuar në politikat e zhvillimit Institucional dhe në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të parametrave të cilësisë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë procesit të mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. Gjatë viteve akademike 2019 - 2020 dhe 2020 - 2021 këto mobilitet kanë qenë më të kufizuara për shkak të situatës të krijuar nga Covid-19. Gjatë vitit akademik 2021 - 2022, me krijimin e mundësive të lëvizjes së lirë pas emergjencës Covid-19, AU ka pasur një sërë mobilitetesh të personelit akademik dhe studentëve **(Evidencë R.19).**

Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që AU ka nënshkruar me institucione të ndryshme dhe marrëveshjeve Erasmus +, kanë përfituar mobilitet 12 anëtarë të personelit akademik dhe 34 studentë tw

Albanian University. Thirrjet për aplikim dhe fituesit, janë transparente dhe publikohen në faqen zyrtare të AU (https://albanianuniversity.edu.al/sq/hapet-thirrja-per-aplikim-per-mobilitet-te-stafit-akademik-ne-kuader-te-programit-erasmus-me-universitetin-biruni-turqi/)

(https://albanianuniversity.edu.al/sq/hapet-thirrja-per-aplikim-per-mobilitet-studentesh-ne-kuader-te-programit-erasmus-me-kirchliche-padagogische-hochschule-vienna-krems-austri/)

(https://albanianuniversity.edu.al/sq/studente-e-programit-te-integruar-te-studimit-te-ciklit-te-dyte-master-i-shkencave-ne-farmaci-anxhela-kastrioti-perfituese-e-mobilitetit-studentor-ne-kuader-te-programit-erasmus/)

AU mbi bazën e kuotave të përcaktuara nga MAS, i jep të drejtën e studimit, studentëve jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë. Aktualisht, pranë AU ndjekin studimet 98 studentë të huaj **(Evidencë 2.60)**

Gjithashtu, AU ndjek një politikë për integrimin e personelit akademik të ftuar dhe të studiuesve të huaj, e cila është në harmoni me kërkesat dhe nevojat si të Institucionit, ashtu edhe të tyre.
AU mirëpret në kuadër të marrëveshjeve institucionale profesorë të huaj për realizimin e procesit mësimor **(Evidencë 2.3).**

**Standardi II.22 Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.**

Programet e studimit në AU ofrohen në përputhje me misionin, qëllimet e Institucionit dhe strategjinë e tij për zhvillim. Njësitë Bazë për çdo program studimi të ofruar kryejnë një analizë të detajuar të tregut të punës (**Evidencë R.4 a,b,c**). Kjo analizë përditësohet periodikisht me të dhëna nga institucione të ndryshme si Instat, QSHA, urdhërat sipas profileve etj**. (Evidencë 2.61 a,b)** (https://albanianuniversity.edu.al/sq/performanca-akademike-e-studenteve-te-diplomuar-dhe-niveli-i-punesimit-te-tyre-ne-tregun-perkates-te-punes/)

Studimi i tregut të punës realizohet nga grupe *ad-hoc* të ngritura në nivel Njësie Bazë dhe synon të evidentojë efikasitetin e programit të studimit në tregun e punës dhe informimin e Institucionit në mënyrë të vazhdueshme për trendin e zhvillimit në fushën përkatëse dhe atë ekonomike rajonale. Pjesë e grupit të ngritur në nivel njësie bazë për realizmin e studimit të tregut të punës janë edhe përfaqësues të kompanive dhe bizneseve të ndryshme me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi **(Evidencë 2.62).**
Në kuadër të studimit të tregut, Institucioni ka arritur të krijojë një panoramikë të situatës, kryesisht në tregun vendas, pavarësisht se shpeshherë është hasur vështirësi në mbledhjen e plotë të të dhënave për shkak të mungesës së një studimi tregu të mirëfilltë të realizuar në nivel kombëtar.
Institucioni vendos për hapjen e programeve të reja, pasi ka kryer hulumtime të nevojshme të tregut të punës, mundësinë e punësimit të studentëve në nivel rajonal, kombëtar e ndërkombëtar, kërkesat e punëdhënësve, etj**. (Evidencë 2.63).**

Programet e studimit reflektojnë ndryshime në kurrikula dhe në metodat të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke u mbështetur thelbësisht në nevojat konkrete të tregut të punës, nën këndvështrimin e zhvillimeve të vazhdueshme e dinamike të shoqërisë.

**<u>Përfundimet dhe Vlerësimi</u>**

"Albanian University" ndjek procedura ligjore dhe transparente në rekrutimin e personelit akademik dhe administrativ. Menaxhimi i burimeve njerëzore është në përputhje me legjislacionin në fuqi. AU ka ndërtuar tashmë një sistem të përzgjedhjes dhe angazhimit të personelit akademik, por edhe atij ndihmës akademik mbi bazën e korrektësisë, transparencës, meritokracisë në funksion të zhvillimit cilësor të programeve të studimit që ofron. AU përdor

metodologji vlerësimi për të gjithë veprimtaritë mësimore dhe kërkimore shkencore, që janë pjesë e punës së përgjithshme të Institucionit. Po ashtu, mundëson trajnimin e personelit të tij akademik dhe ndihmës akademik me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale. AU ka qëndrueshmëri të personelit akademik nga akreditimi i fundit.
Institucioni në përmbushje të misionit dhe qëllimeve të tij e shikon partneritetin kombëtar dhe ndërkombëtar si element themelor, për pjesëmarrjen në projekteve të ndryshme, nxitjen e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të parametrave të cilësisë.

Dokumentacioni i lidhur me të dhënat financiare është i rregullt dhe dëshmohet edhe nga rezultatet e kontrolleve periodike, të cilave u është nënshtruar Institucioni.

Universiteti mbështetet në kapacitetet e brendshme dhe të jashtme për miratimin e çështjeve buxhetore. Përdorimi i burimeve financiare është subjekt i rishikimit dhe i monitorimit të vazhdueshëm.
Institucioni ofron një infrastrukturë moderne dhe bashkëkohore në funksion të programeve të studimit që ofron.

AU ka rritur numrin e mobiliteteve dhe projekteve të aplikuara, fituara dhe zbatuara gjatë viteve të fundit. Institucioni ka forcuar bashkëpunimet ekzistuese dhe ka zgjeruar më tej bashkëpunimet me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

## III – PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI

**Standardi III.1 Institucioni ofron programe në përputhje me misionin, strategjinë e tij të zhvilimit dhe kërkesat e tregut.**

“Albanian University” është Institucion i Arsimit të Lartë, i cili ofron programe studimi në fushat e mjekësisë, të shkencave të aplikuara, ekonomike, shoqërore dhe art dizajnit, në të tre ciklet e studimit: Cikli i Parë, Cikli i Dytë dhe Cikli i Tretë, referuar përkatësisht nivelit të 6-të, 7-të, dhe 8-të, në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimit. Programet e studimit në AU ofrohen në përputhje me Statutin **(Evidencë 1.1),** vizionin dhe misionin e Institucionit, Strategjinë e Zhvillimit Institucional **(Evidencë 1.6, Evidencë 1.4, Kreu IV, Neni 36)**, si dhe Ligjin 80/2015 dhe aktet rregullatore në fuqi. Institucioni ofron 41 programe studimi në të tre ciklet, Bachelor, Master dhe Specializime Afatgjata në fushën e stomatologjisë **(Evidence 3.1 a.b)**. AU ka aplikuar për riorganizimin/hapjen e programeve të Ciklit të tretë Doktoratë. Fushat që mbulohen nga programet e studimit të ofruara, përcaktojnë edhe profilin e institucionit, si një Universitet me spektër të gjerë.

Programet e studimeve të ofruara nga Institucioni janë të organizuara në mënyrë të tillë që të harmonizojnë të gjithë komponentët e tyre. Programet e studimit ofrohen nga Njësitë Bazë (departamentet), pjesë përbërëse e tre Njësive Kryesore (Fakultete) të AU. Ato janë në përputhje me profilin e departamenteve dhe të fakulteteve që i ofrojnë.

AU ka aplikuar pranë MAS për riorganizimin dhe hapjen e disa programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve **(Evidencë 3.2.a.b.c.d.e.f.g.i.j.k), (Evidencë 3.3)**. Gjithashtu, AU në dhjetor 2021 ka riaplikuar për hapjen (dy programe të reja doktoratë) dhe riorganizimin (tre programe doktoratë dhe një program specializimi afatgjatë) e programeve të ciklit të tretë të studimeve **(Evidencë 2.63).**

“Albanian University” informon në mënyrë të vazhduar të interesuarit mbi programet e studimit që ofron në të tre ciklet e studimit. Informimi bëhet jo vetëm përmes publikimit të tyre në *website*-n e Universitetit (https://albanianuniversity.edu.al/), rrjetet sociale të tij, por edhe përmes pjesëmarrjes në aktivitete informuese **(Evidence 2.7),** panaire të ndryshme **(Evidencë 2.9),** përmes të cilëve informon maturantët dhe palët e interesuara në lidhje me ofertën akademike të Universitetit, objektivat formuese të programeve të studimit, si dhe kriteret e pranimit në to. Gjatë periudhës Shkurt-Qershor, drejtuesit e departamenteve, në bashkëpunim me anëtarë të personelit ndihmës akademik, Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, si dhe Zyrën e Karrierës dhe Alumnit, realizojnë takime informuese me maturantët për ofertën akademike, si dhe mundësitë që ofron “Albanian University” për edukimin në të tri ciklet e studimit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/albanian-university-nis-fushaten-promovuese-te-universitetit-per-vitin-akademik-2022-2023/). Gjithashtu, AU organizon Open Days, gjatë të cilave fton maturantët dhe studentët në ambientet e secilit Fakultet, për t’u njohur nga afër edhe me programet e studimit, personelin akademik, infrastrukturën në mbështetje të mësimdhënies, apo mundësitë që ofron tregu i punës (https://albanianuniversity.edu.al/sq/?s=open+day ) **(Evidencë 3.4).** Informimi i studentëve është një proçes i vazhdueshëm në AU, duke filluar që në periudhën e aplikimeve dhe regjistrimeve, në të cilën anëtarë të personelit akademik dhe ndihmës-akademik orientojnë studentët kandidatë duke i informuar më shumë mbi programet e studimit dhe duke vazhduar gjatë gjithë viteve universitare me këshillimin mbi zhvillimin e karrierës së tyre.

Pranimet në AU mbështeten në kriteret që janë të përgjithshme dhe të zbatueshme për çdo kandidat, që

aplikon në një program studimi, në të tre ciklet e studimit. Kriteret vendosen bazuar në aktet ligjore/rregullatore të Ministrisë përgjegjëse dhe në rregulloret e brendshme të Universitetit **(Evidencë 2.45).** Kuotat dhe kriteret e pranimit për kandidatët për studentë në AU, miratohen me Vendim Senati Akademik, në mbështetje të Vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, si dhe në përputhje me propozimet e Departamenteve në AU **(Evidencë 3.5 a.b) (Evidencë 1.15 Neni 3, pika 2.a)** Ato bëhen publike edhe në faqen web të universitetit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit-2/).

Për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, AU merr në konsideratë rezultatin e përgjithshëm të shkollës së mesme të kandidatit bazuar në kriteret e mesatares për profilet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të përditësuara.

Për ciklin e dytë të studimeve, kriteret propozohen nga departamenti dhe miratohen nga dekani. Pas miratimit ato bëhen publike në faqen zyrtare web të Universitetit, (https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit-2/) dhe në mjediset e fakultetit. Pranimi i studentëve në AU, në të gjitha ciklet e studimeve, kufizohet nga kuotat e pranimeve për çdo program studimi. Kuotat propozohen nga departamentet, miratohen në Dekanatin e Fakultetit, dhe në Senatin Akademik të AU dhe marrin miratimin e MAS. Në ndarjen e kuotave, një pjesë e tyre, lihen në dispozicion të kategorive të veçanta të studentëve, kandidatë nga trojet shqipfolëse jashtë kufijve, shtetas të huaj, shtresat në nevojë, kandidatë me aftësi të veçantë, studentë me transferim studimesh apo program të dytë studimi **(Evidencë 2.34).** Në planifikimin e numrit të studentëve në hyrje, departamentet dhe fakultetet marrin në konsideratë:

- Prirjet dhe kërkesat e shprehura nga kandidatët për programin e studimit referuar vitit të mëparshëm akademik.

- Infrastrukturën në dispozicion: ambientet e mësimdhënies në fakultet, vendet e punës në laboratore, numrin e stafit akademik efektiv dhe ngarkesën e tyre. Kuotat certifikohen nga MAS pas verifikimit të kapaciteteve pritëse që ka AU për çdo program studimi **(Evidencë 3.6)**. AU është fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes infrastrukturore dhe kushteve mjedisore, si dhe në rritjen e kapaciteteve pritëse në fakultete të ndryshme. Nga ana tjetër po vijon procesi i rikonstruksionit të pjesëve të veçanta të godinës qendrore, ku janë vendosur Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe zhvillojnë mësimin edhe grupet e Departamentit të Infermierisë e Fizioterapisë. Përveç rikonstruksioneve, vëmendje i është kushtuar riparimeve dhe rinovimeve të ambienteve të brendshme, nyjeve higjenosanitare të godinave të AU, si dhe përshtatje infrastrukturore të disa sallave, e cila do të sigurojë një shtim të sipërfaqeve të shfrytëzueshme me rreth 500 $m^2$. Përveç investimeve në shtim sallash, rikonstruksione, riparime, rinovime të godinave ekzistuese, vëmendje i është kushtuar përmirësimit dhe rinovimit të laboratorëve në disa prej godinave **(Evidence 2.32)**. Një drejtim tjetër për të rritur kapacitetet pritëse është shtimi i personelit akademik efektiv, nëpërmjet punësimeve të vazhdueshme, mbështetur në nevojat dhe propozimet e departamenteve. Të gjitha këto kanë sjellë një përmirësim të indikatorëve matës të kapaciteteve pritëse dhe sot, situata është si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2021 – 2022, nga përllogaritjet e hapësirave fizike për Fakultetin e Shkencave Mjekësore dhe përdorimit të të gjitha godinave te AU, kemi raportin 3.6 $m^2$ per student. Kriteret plotësohen edhe për programet në fushën e Inxhinierive dhe Art Dizajn, të cilët përdorin 6.7 $m^2$ për student, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Ekonomike përdorin minimalisht 3 $m^2$ për student.

2. Raporti staf akademik/student në nivel universiteti, për vitin akademik 2021 - 2022 i ndarë sipas

fakulteteve është si mëposhtë:

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore raporti staf akademik/student 1/21.

- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike - raporti staf akademik/student 1/35.

- Fakulteti i Shkencave Shoqërore raporti staf akademik/student 1/26 **(Evidencë 3.6).**

3. Ngarkesa mësimore e realizuar nga stafi akademik efektiv është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi **(Evidence 3.7).**

"Albanian University" ka përcaktuar kriteret e saj për organizimin e një programi studimi, si dhe procedurat për hartimin/riorganizimin, përmirësimin dhe miratimin e një programi studimi **(Evidencë 3.8).**

Programet e studimit hartohen në përputhje me Kartën e Bolonjës dhe nevojat e dala nga studimi i Tregut të Punës **(Evidence R.4 a.b.c)**, dhe janë në harmoni me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim që synon të përmbushë nevojat e tregut të punës në vend. Njësitë Bazë në bashkëpunim me bizneset dhe bazuar në tregun e punës hartojnë dhe riorganizojnë programet e tyre të studimeve **(Evidencë 3.9.a.b).**

**Standardi III.2 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.**

Arsimimi në AU organizohet i koordinuar në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 dhe në bashkërendim me vendimet e amendimet e Ministrisë përgjegjëse për Arsimin.
AU ofron programe studimi në të tre ciklet e studimit, në përputhje me procesin e Bolonjës, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Kriteret e pranimit, të vendosura nga IAL-të, mbështeten kryesisht në arritjet e maturantëve dhe kandidatëve në arsimin e mesëm të lartë. Aplikimi i kandidatëve për studentë nëpërmjet portalit U-Albania ka bërë të mundur ruajtjen e parimit bazë "meritë-preferencë". Vendosja e pragut hyrës të mesatares të Arsimit të Mesëm të Lartë ka rritur cilësinë e studentëve të regjistruar në programet "Bachelor".

Në hapjen e programeve të reja të studimit, por edhe në përditësimin e tyre janë marrë në konsideratë objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvillimit, si dhe janë realizuar studime tregu, në të cilat përfshihen të gjithë aktorët, siç janë stafi akademik dhe specialistë të fushës, por edhe përfaqësues nga bizneset me qëllim përmirësimin e ofertës akademike në funksion të plotësimit të nevojave të tregut të punës **(Evidencë R.3)**. "Albanian University" ka mision formimin e një qytetari të denjë, i cili është i përgatitur për tregun e punës në një shoqëri globale, i shërben ekonomisë duke përdorur dijet dhe teknologjinë si mjet i domosdoshëm, por njëherazi promovon nëpërmjet kontributit të tij një zhvillim të qëndrueshëm në shoqëri duke u karakterizuar nga vlerat qytetare dhe integriteti.
Në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim veçojmë Objektivin "Forcimi i lidhjeve midis të nxënit dhe punës dhe lehtësimi i kalimit në punë".
Lidhur me këtë "Albanian University" ka plotësuar masat si bërjen e praktikave profesionale në biznese pjesë integrale të programeve (kurrikulave), zgjedhjen e një koordinatori (pedagog) që shoqëron dhe siguron kryerjen e praktikave në biznese **(Evidencë 3.10)**, vlerësimin e praktikave profesionale mbi bazën e një raporti **(Evidencë 2.39).**
Përveç qëllimeve dhe misionit që kanë programet e studimit për të formuar profesionistë dhe qytetarë të denjë, Universiteti realizon edhe veprimtari të bashkëpunimit me universitete brenda dhe jashtë vendit

për t'i ekspozuar studentët me çështje rajonale e ndërkombëtare, të cilat kanë si qëllim diskutimin e çështjeve aktuale që i përkasin vendit tonë dhe lidhjes me rajonin e më gjerë siç janë: problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë shqiptare drejt sfidave të BE, sfidat në sistemin shëndetësor, në sistemin e drejtësisë, zhvillimi ekonomik rajonal, arsimi dhe e ardhmja e tij, si dhe veprimtari dhe diskutime që janë lidhur me zhvillimin e artit në të gjitha format e tij, etj. **(Evidencë 2.57)**.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në AU menaxhohet nga zyra e marrëdhënieve me jashtë por jo vetëm. Zyra dhe Departamentet bashkëpunojnë ngushtë me IAL-të e huaja për krijimin e lëvizshmërisë (mobilitetit), si dhe mbulojnë zbatimin e marrëveshjeve bilaterale dhe shumëpalëshe dhe zbatimin e projekteve ndërkombëtare. Zyra bashkëpunon ngushtë me Zyrën Shqiptare Erasmus + nëpërmjet aktiviteteve të tilla si: organizimi i ditëve Erasmus +, (https://albanianuniversity.edu.al/sq/albanian-university-ndjek-diten-informuese-mbi-programet-erasmus/), aktivitetet informuese PKKZH, COST, seminareve të ekspertëve, seancave informuese në vend për programet e BE-së, etj.

**Standardi III.3 Programet kanë objektiva të përcaktuar qartë dhe rezultatet e tyre të të nxënit përputhen me nivelin e profilin kualifikimit që ofrojnë.**

Në rregulloret mësimore të çdo programi studimi të ofruara në AU, janë të specifikuara qartë objektivat e programit përkatës **(Evidencë 3.10).** Lista e programeve të studimit, planet mësimore, ngarkesa në kredite, objektivat e tyre formuese, si dhe informacioni mbi licensimin dhe akreditimin e tyre, publikohet në faqen zyrtare të Universitetit. Çdo student apo kandidant për student ka mundësi të informohet në çdo kohë për ofertën akademike në AU (http://albanianuniversity.edu.al/sq/category/programe-studimi/). Programet e studimit janë të pajisura me syllabuse për secilën lëndë, në të cilin parashikohen objektivat dhe rezultatet e të nxënit **(Evidencë 3.11).** Në javën e parë të mësimit, për çdo lëndë, pedagogu i lëndës njeh studentët me përmbajtjen e lëndës (syllabusin) duke vënë theksin tek detyrimet akademike, frekuentimi dhe format e vlerësimit **(Evidencë 3.12), (Evidencë 2.6)**. Lëndët mund të jenë të detyrueshme ose me zgjedhje në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Universiteti ofron mundësi për transferim kreditesh ndërmjet programeve të të njëjtit nivel si brenda Universitetit, ashtu edhe në institucione të tjera të arsimit të lartë, si dhe i përgatisin studentët për punësim dhe për ecurinë e mëtejshme në studimet e nivelet pasardhëse **(Evidence 2.45).**

Gjithashtu, gjatë periudhës së aplikimeve dhe regjistrimeve, personeli akademik dhe ndihmës akademik këshillon dhe orienton maturantët/studentët mbi programet e studimit të ofruara dhe çdo detaj tjetër që lidhet me objektivat e tyre të karrierës.

**Standardi III.4 Institucioni përcakton qartë dhe ndjek procedurat për miratimin e programeve të reja.**

Departamentet në funksion të kërkesave të tregut të punës, të ekspertizës së departamentit ose në zbatim të objektivave të projekteve të ndryshme për ngritje kapacitetesh, etj., janë përfshirë në procesin e hartimit të programeve të reja të studimit. Fokusi ka qenë kryesisht në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, ndërkohë që përgjatë semestrit të parë të v.a. 2021 - 2022, departamentet u angazhuan për aplikimet në programet e ciklit të tretë" Doktoratë". Gjatë tri viteve të fundit, është aplikuar pranë MAS për hapjen e disa programeve të studimit miratuar nga Senati Akademik i AU **(Evidence.2.63).** Viti i ri akademik 2022-2023 fillon me një program të ri ndërkombëtar në "Albanian University". "Odontoiatria e Protesi Dentaria", program i përbashkët me Univeristetin e Ferrarës, lincensuar nga MAS me Urdhër Nr.444, datë 22.07.2022, Nr.4941/$_1$ Prot.,. Procedura për hapjen e një programi të ri studimi është përcaktuar në Rregulloren e Mbarëvajtjes së Kurrikulave dhe Procesit mësimor **(Evidencë 3.8).** Standardet për organizimin e programeve të studimit kanë pësuar ndryshime të herëpashershme, me ndryshimin e kornizës ligjore për arsimin e lartë. Kjo ka bërë që në AU të rishikohen dhe të

riorganizohen të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. Gjatë këtij procesi janë bërë përmirësime të kurrikulave dhe syllabuseve, ndryshime të emërtimeve të programeve të studimit, ndryshime në planin mësimor, në kreditet e lëndëve, në shpërndarjen e krediteve sipas aktiviteteve formuese të lëndës, etj. Riorganizimi i programeve të studimit në masën mbi 20% të përmbajtjes, e shprehur në kredite, si dhe ndryshimi i emërtimit të tij është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Rishikimi dhe përmirësimi i programeve të studimit, të cilat prekin më pak se 20% të përmbajtjes së tij, të shprehur në kredite, është miratuar nga Senati Akademik i AU dhe është informuar ministria përgjegjëse për arsimin **(Evidenca 3.12), (Evidenca 3.2).**

**Standardi III.5 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit.**

"Albanian University" analizon kapacitetet pritëse dhe bashkërendon numrin e studentëve të programeve ekzistuese me propozimet për hapjen e programeve të reja dhe konfirmon me departamentet këto kapacitete përpara se t'i dërgojë në MAS (**Evidence 3.6).**

AU bazuar në kapacitetet fizike dhe njerëzore realizon në mënyrë optimale programet e studimit në përputhje me kërkesat ligjore. Shpërndarja e ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me nevojat e njësive bazë, mbështetur në kuadrin ligjor, duke konsideruar llojin e angazhimit në Universitet të stafit akademik, kualifikimin dhe përvojën në mësimdhënie **(Evidencë 3.7).**

Në aneks kontratat individuale të punës të personelit akademik përcaktohet ngarkesa semestrale. Është në interes të Institucionit balancimi i ngarkesës dhe veprimtarive të tjera në Universitet që lidhen me kërkimin shkencor dhe detyra të tjera të stafit akademik **(Evidencë 2.20 a.b).**

**Standardi III.6 Programet e studimit janë të organizuar në cikle studimi.**

Organizimi i Programeve të Studimit bëhet në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në fuqi. Të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, në përputhje me kërkesat ligjore, ofrohen me kohë të plotë. Organizimi i Programeve të Studimit dhe numri i tyre, sipas cikleve të studimit është si më poshtë:

- Cikli i Parë i Studimeve

Në Ciklin e Parë të Studimeve ofrohen gjithsej 15 Programe Studimi të licencuara, të gjitha aktive në Vitin Akademik 2021 - 2022. Programet e studimit të Ciklit të Parë ofrohen me 180 ECTS në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të studimeve, studenti fiton Diplomë "Bachelor" në fushën përkatëse **(Evidencë 3.13)**.

- Cikli i Dytë i Studimeve

Në ciklin e dytë të studimeve ofrohen Programet e Studimit si mëposhtë:

Programe studimi "Master i Shkencave", të cilat janë të organizuara me 120 ECTS, në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike. Në përfundim të studimeve, studenti fiton Diplomën "Master i Shkencave" në fushën përkatëse **(Evidencë 3.14).** AU ofron 7 programe studimi Master i Shkencave.

Programe studimi të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave", të organizuara me 300 ECTS në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e tyre është 6 vite akademike. Në përfundim të studimeve, studenti fiton Diplomën "Master i Shkencave" në fushën përkatëse. Në AU

ofrohen gjithsej 3 programe të integruara të ciklit të dytë në fushën e stomatologjisë, farmacisë dhe drejtësisë, të gjitha aktive në vitin akademik 2021 - 2022 **(Evidencë 3.15).**

Programe studimi "Master Profesional", të cilat ofrohen me 60 ECTS në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e tyre është përkatësisht 1 vit akademik. Në përfundim të studimeve, studenti fiton Diplomën "Master Profesional" në fushën përkatëse ***(*Evidencë 3.16).** AU ofron 12 programe studimi Master Profesional me 60 ECTS.

- Cikli i Tretë i Studimeve

Programet e Studimit në Ciklin e Tretë janë të organizuara në bazë Departamenti, të fokusuara kryesisht në;

- Studime të Doktoratës në fushat Juridike, Psikologjike, Administrative, Farmaceutike (janë aplikuar për riorganizim) duke kontribuar në anën akademike dhe në plotësimin e stafit të brendshëm akademik me grada që i shërbejnë mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

- Studime të Specializimeve Afatgjata në fushën e mjekësise, konkretisht në Kirurgji Orale dhe Ortognatodonci **(Evidencë 3.17).**

"Albanian University" nga viti akademik 2020-2021 ofron dhe një program studimi me karakter profesional ne fushën e stomatologjisë, ''Laborant i lartë dentar'' **(Evidencë 3.18).**

Programet e studimit, për të tre ciklet janë të publikuara në "website" e universitetit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-2/) (https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-shoqerore-2/) (https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/) (https://albanianuniversity.edu.al/sq/doktoratura/) (https://albanianuniversity.edu.al/sq/specializime/) si dhe në portalin U-Albania.

**Standardi III.7 Programet e studimeve nga cikli në cikël hartohen me qëllim mirëorientimin dhe përftimin gradual të njohurive nga studentët.**

Programet e studimit janë hartuar bazuar në aktet ligjore në fuqi, në mënyrë të tillë që të mundësojnë kalimin nga Cikli i parë i studimeve në Ciklin pasardhës duke siguruar koherencë dhe vazhdimësi në përmbajtje. Programet e studimit të ciklit të parë *Bachelor*, kanë për qëllim të pajisin studentin me njohuri dhe koncepte bazë, me aftësi analitike, krijuese, vendimarrëse, duke u bazuar në metoda shkencore dhe të përgjithshme. Kjo evidentohet në numrin e krediteve të dedikuara për lëndët sipas kategorive përkatëse në përputhje me bazën ligjore përkatëse **(Evidence 3.19)**. Për përfundimin e studimeve të Ciklit të parë, studenti duhet të fitojë 180 kredite ECTS.

Në përfundim të studimeve të ciklit të parë, studenti ka të drejtë të diplomohet dhe të fitojë diplomën "Bachelor". Programet mësimore hartohen në mënyrë të tillë që t'u ofrojnë studentëve njohuri, të cilat do të jenë të nevojshme për integrimin e tyre në tregun e punës dhe në të njëjtën kohë t'u përgjigjen kërkesave me të cilat ata do të përballen gjatë realizimit të tyre profesional **(Evidencë 3.10 Kreu II, neni 4).** Mundësitë e punësimit të studentëve që përfundojnë studimet në AU përcaktohen qartë që në hapje të programit të studimit, publikohen në web, si dhe në manifestin akademik (https://albanianuniversity.edu.al/sq/departamenti-i-edukimit-dhe-anglishtes/) Që në momentin e regjistrimit, studentëve u jepet informacion për mundësitë e punësimit pas diplomimit, akreditimin e Institucionit dhe të programit të studimit që ofrohet, si edhe njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga "Albanian University" (https://albanianuniversity.edu.al/sq/albanian-

university-nenshkruan-marreveshje-bashkepunimi-me-medicalb-work-agency-per-te-nxitur-punesimin-e-studenteve/).

Programet e studimit nga njëri cikël në tjetrin kur ruhet i njëjti profil kanë lëndë të ngjashme që ruajnë profilizimin e njohurive dhe e përgatisin studentin në mënyrë specifike **(Evidencë 3.20)**. Në momentin e regjistrimit të studentit në ciklin e dytë Master, stafi akademik dhe administrativ i "Albanian University" ofron këshillim dhe orientim për të lehtësuar zgjedhjen dhe profilizimin e dijeve (https://albanianuniversity.edu.al/sq/ditet-e-informimit-mbi-programet-master-fakulteti-i-shkencave-shoqerore/)

Leksionet, seminaret, orët laboratorike, projektet, praktika profesionale të zhvilluara, si dhe mënyra interaktive e zhvillimit të mësimit janë një përvojë e mirë për përfitimin e dijeve dhe që nxit studentët të vazhdojnë studimet në ciklet pasardhëse në AU.

**Standardet III.8 Institucioni ofron programe të të nxënit gjate gjithë jetës.**

AU prej vitesh ka organizuar trajnime, workshope, evente shkencore duke bërë të mundur që studentët dhe profesionistët pjesëmarrës në këto aktivitete të certifikohen dhe të vlerësohen me kredite në profesionet e rregulluara si: Stomatologji, Infermieri dhe Farmaci. Gjithashtu, falë eksperiencës pozitive dhe besueshmërisë që Institucioni ka fituar në seriozitetin e organizimit të konferencave shkencore, Qendra Kombëtare e Edukimit në vazhdim ka miratuar "Statusin e ofruesit të akredituar të aktiviteteve të edukimit në vazhdim, për profesionistët e shëndetësisë", duke nisur nga viti akademik 2018 - 2019 **(Evidencë 2.26).**

"Albanian University" nis në vitin akademik 2021 - 2022 programin trajnues 10 javor " Lidership për shekullin XXI" me pjesëmarrje të gjerë të alumni të Universitetit. Trajnimet ofrohen falas nga "Albanian University" me synimin kryesor rritjen profesionale në vazhdimësi të ish-studentëvë të tij dhe si përftim të një kompetence më shumë për të mundësuar aksesin e tyre në tregun e punës (https://albanianuniversity.edu.al/sq/nisi-ne-albanian-university-programi-i-trajnimit-lidership-per-shekullin-xxi/)

**Standardi III.9 Programet e studimeve mbështeten në profilin kërkimor dhe profesional të njësisë dhe realizohen në bashkëpunimin me aktorë të fushës.**

Hartimi, monitorimi dhe përditësimi i Programeve të Studimit përbën një objektiv të rëndësishëm krahas mësimdhënies dhe mësimnxënies në "Albanian University". Këto programe synojnë të ofrojnë njohuri bazë, parime shkencore të përgjithshme dhe aftësitë e veçanta të nevojshme për punësim apo avancim në nivelet pasardhëse.

Përveç procedurave standarde të rishikimit dhe propozimit të programeve të reja të studimit që paraprihen nga një studim tregu **(Evidence R.4 a.b.c)** që përfshin rekomandimet dhe nevojat e industrisë/sektorit për profilet që ofrohen në "Albanian University" (**Evidencë 3.12**), stafi akademik i angazhuar përfaqëson ekspertë të fushës/profilit me eksperiencë dhe arritje të spikatura në atë fushë **(Evidence 2.3).**

**Standardi III.10 Programet e studimeve monitorohen në mënyrë periodike.**

Programet e studimit në AU ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional dhe vlerat që ndan institucioni **(Evidencë 1.1).** Një ndër objektivat më të rëndësishme në planin strategjik të zhvillimit të AU 2017 - 2022 është konsolidimi dhe përmirësimi i programeve të studimit që ofron, në përputhje me objektivat e formimit dhe impaktit shoqëror. Në kuadër të përmbushjes së këtij objektivi, AU ka

rishikuar në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm bazuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, në përputhje me nevojat e diktuara nga studimi i tregut të punës bazuar në zhvillimin ekonomik, demografik dhe teknologjik të vendit, të gjitha programet që ofron, deri në masën e lejuar 20% **(Evidence 3.12).** Procedura e rishikimit të kurrikulave fillon me ngritjen në nivel njësie bazë të grupeve *ad hoc*, pjesë e të cilave janë edhe anëtarët e Grupeve të Sigurimit të Cilësisë në departamentet përkatëse. Ky proces realizohet nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave (ZZHK), e cila ofron asistencë teknike si dhe rekomandime **(Evidencë 1.4, neni 16), (Evidencë 3.8).** ZZHK i ka mundësuar të gjitha njësive bazë një format të planit mësimor të detajuar duke i ardhur në ndihmë grupeve të punës në përmbushjen e kritereve për elementët e programeve të studimit. Në të njëjtën kohë, ZZHK ka rishikuar formatin e syllabuseve/programit lëndor, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, shtojca 2, duke mundësuar kështu unifikimin e kurrikulave dhe syllabuseve në nivel Institucional **(Evidencë 1.28 aneks 1&2)** Në fillim të çdo viti akademik, të gjitha syllabuset përditësohen në përputhje me ndryshimet në planet mësimore, si dhe duke vënë theksin tek ofrimi i literaturave bashkëkohore **(Evidencë 3.21).** Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, pranë AU është ngritur edhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin (KKM) **(Evidencë 3.22)** Të gjitha propozimet e njësive bazë janë shqyrtuar nga KKM, janë miratuar nga Senati Akademik në AU, si dhe kanë marrë miratimin përkatës nga ministria përgjegjëse për arsim.

**Standardi III.11 Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë.**

Programet e studimit në Albanian University përmiresohen në mënyre të vazhdueshme për të mundësuar rritjen e cilësisë. Vlerësimi realizohet duke u bazuar në elementët e mëposhtëm:

- Vlerësim nga njësia kryesore **(Evidencë 1.23)** mbi bazën e raportit të hartuar nga njësia bazë **(Evidencë 1.22)** në të cilin përfshihen të dhëna rreth programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafi akademik i rekrutuar, literatura e re në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen,

- Vlerësimi nga drejtuesi i departamentit **(Evidencë 2.12)** – që realizohet çdo fund viti në formën e një raporti përmbledhës për secilin pedagog, në të cilin konsiderohen: vlerësimi mesatar i marrë nga pyetësorët drejtuar studentëve, vlerësimi mbi korrektësinë e realizimit të orëve të mësimit përmes raportit semestral të hartuar nga pedagogët **(Evidencë 1.26)** vlerësimi i drejtuesit të departamentit mbi angazhimin në çështjet administrative të departamentit, mbi veprimtarinë kërkimore - shkencore dhe trajnimet e pedagogut, bazuar në vetë - deklarimet e tyre përmes formularit të veprimtarisë kërkimore – shkencore **(Evidencë 2.22)**.

- Vlerësim nga pedagogët - gjatë vitit akademik 2021 – 2022, pedagogët i janë nënshtruan një pyetësori, përmes të cilit shprehën mendimet e tyre lidhur me aspekte të ndryshme të punës në Universitet **(Evidencë 2.13)**.

- Vlerësim nga studentët nëpërmjet pyetësorëve, 2 herë në vit, një në përfundim të semestrit të parë dhe një në përfundim të semestrit të dytë **(Evidence 1.24 b), (Evidence 2.19 b).**

- Fokus grupe me studentët për mendime dhe propozime më specifike për programet mësimore dhe jetën universitare në përgjithësi që organizohen nga NJSBC sipas axhendës së tyre **(Evidencë 1.25 a.b.c.d).**

- Çdo fillim viti, nën kujdesin e koordinatororëve të grupeve mësimore, personeli akademik angazhohet në rishikimin e syllabuseve të lëndëve, me qëllim pasurimin dhe përditësimin e tyre bazuar në të rejat më të fundit në fushat përkatëse **(Evidencë 3.21).**

- Statistika të Alumnit mbi numrin e të punësuarve në përputhje me fushën e studimit **(Evidencë R.5)**.

Pasi janë marrë rezultatet nga të gjithë përbërësit e përmendur më lartë, NJSBC i paraqet Rektoratit vlerësimin duke hartuar raportin vjetor **(Evidencë 1.27).**

**Standardi III.12 Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.**

Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies bazuar në Strategjinë 3-vjeçare të Sigurimit të Cilësisë **(Evidencë 1.20).** Institucioni në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, ka ngritur strukturat përkatëse, të cilat janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave (**Evidencë 1.4, Neni 14, 16, fq. 16 – 18)**, si dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin **(Evidencë 1.4, Neni 15, fq. 18).** Bazuar në indikatorët e performancës së stafit akademik PAE/PAK, hartuar në nivel Njësie Bazë rezulton se stafi ka një eksperiencë mësimdhënie cilësore, e cila lidhet me periudhën mbi 5 vite mesimdhënie për mbi 75% të tij **(Evidencë 2.21).** Pedagogët e rinj i janë bashkëngjitur trupës mësimëdhëse duke gërshetuar më së miri eksperiencën e tyre me dëshirën për mësimdhenie të më të rinjve. Çdo fillim viti akademik ofrohen trajnime për metodologjinë dhe metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, nga pedagogë të AU dhe specialistë të jashtëm **(Evidencë 2.5 a.b).** Pedagogë të huaj përfshihen në mësimdhënie, në kërkim shkencor dhe aktivitete të ndryshme si: konferenca, *workshop*-e, trajnime etj **(Evidencë 2.3).**

Institucioni vë në dispozicion të mësimdhënies jo vetëm auditorët, por edhe paketën Office 365, një instrument për zgjerimin e mësimdhënies *online*, për shpërndarjen e materialeve mësimore, zhvillimit të detyrave, komunikimit me studentët etj. **(Evidencë 3.23).** AU synon modernizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të metodave të mësimdhënies duke u mbështetur në teknologjitë bashkëkohore të komunikimit dhe zhvillimit. Në mënyrë të veçantë, për arsye të pandemisë, gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 - 2020 dhe vitit akademik 2020 – 2021, procesi mësimor është zhvilluar online. Për këtë, janë shfrytëzuar platformat Microsoft Teams, Google Classroom dhe Zoom **(Evidencë 3.24).** Vështirësitë eventuale kanë qenë ato që lidhen me pajisjen e studentëve me infrastrukturën e nevojshme kompjuterike dhe cilësinë e kërkuar për një zhvillim cilësor të mësimit. Për të plotësuar mangësitë në këtë drejtim është bërë e mundur që leksionet, seminaret dhe elementë të tjerë të përfshirë në programet e lëndëve të vihen në dispozicion edhe në format video me qëllim përdorimin e tyre edhe off-line.

Institucioni ofron ambjente të përshtatshme në funksion të mbarëvajtjes së mësimdhënies: të gjitha sallat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme imobiliare dhe me mjetet e nevojshme teknologjike: kompjuter, videoprojektor, etj. Të gjitha godinat mbulohen nga rrjet interneti *wireless*, e disponueshme për të gjithë. Në bibliotekat e fakulteteve gjenden, në format *hardcopy*, titujt e librave kryesorë të literaturës së detyruar në syllabuset e lëndëve **(Evidencë 2.42)**, si dhe dispensa të përgatitura nga pedagogët në gjuhën shqipe, bazuar në literaturë të huaj bashkëkohore. Çdo fillim viti akademik, në përputhje edhe me rishikimet e syllabuseve, departamentet bëjnë kërkesat e tyre për shtimin e librave në bibliotekë, si në tituj edhe në numër **(Evidencë 3.25)**. Në ambjentet e bibliotekave, vihen në dispozicion të studentëve kompjutera/terminale, duke mundësuar kërkimin në internet dhe aksesimin e librarive *online* të këshilluara nga departamenti përkatës. Veprimtaria e personelit akademik, personelit ndihmës akademik me karakter mësimor dhe personelit ndihmës akademik me karakter administrativ **(Evidencë 1.1, Kreu IV, fq. 23),** është në funksion të mbarëvajtjes akademike dhe administrative të programeve të studimit të ofruara nga Institucioni. Institucioni vë në dispozicion të studentëve literaturën e nevojshme, e cila pasurohet çdo fillim viti akademik me tituj bashkëkohorë. Pedagogët orientojnë studentët për shfrytëzimin e literaturës në bibliotekat e universitetit **(Evidenca 2.42)**, si dhe në libraritë *online*.

Institucioni punon në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar një organizim sa më korrekt dhe efikas të procesit mësimor për të gjitha programet e studimit që sipas fakulteteve, publikohen në faqen zyrare të Institucionit https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/programe-studimi.

Menaxhimi i procesit mësimor realizohet në nivel njësie kryesore, e cila, në bashkëpunim me njësitë bazë, të cilat janë përgjegjëse për programet e studimit respektive, koordinon aktivitetin mësimor në përputhje me strukturën e miratuar vjetore të procesit mësimor **(Evidence 3.26, Evidence 3.27, Neni 10).**

Përpara fillimit të semestrit përkatës të vitit akademik, në ambientet e fakulteve dhe në faqen web, shpallen oraret mësimore të hartuara në përputhje me planin mësimor. Veprimtaritë formuese të lëndës përbëhen nga leksione, ushtrime/seminare, detyra/projekte kursi, laboratorë dhe praktika mësimore **(Evidencë 3.28).** Mësimdhënia, në kushte normale, realizohet në auditor, referuar veprimtarive formuese që përbëjnë lëndën. Në AU mësimdhënia realizohet kryesisht në formën e vet klasike:

• leksionet, të cilat zhvillohen në grupe më të mëdha studentësh, ku pedagogu shtjellon konceptet teorike dhe zhvillimet në fushën përkatëse. Metodat e mësimdhënies këtu janë nëpërmjet kombinimit të prezantimeve me videoprojektorë dhe shtjellimeve në tabelë. Sallat e leksioneve janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike për realizimin e leksioneve.

• ushtrime/seminare, që zhvillohen në grupe mësimore, në të cilat synohet të zbërthehen praktikisht temat e zhvilluara në leksione. Seminaret janë të lidhura kryesisht me diskutime teorike në klasë në lidhje me tematikat e trajtuara në leksion. Kjo formë përdoret kryesisht në disiplina të fushave teorike.

• laboratorë, të cilat zhvillohen në grupe të vogla studentësh (8-12 studentë), në të cilat studentët realizojnë praktikisht në laboratorë, nën mbikëqyrjen e pedagogut, një detyrë të caktuar duke kryer matje të ndryshme. Studentët njihen me pajisjet laboratorike, metodologjinë e matjeve dhe përpunimit të rezultateve, dhe fitojnë aftësi praktike në provat laboratorike **(Evidence 3.29).**

• detyra/projekte kursi, të cilat janë individuale për çdo student, ose realizohen në grupe të vogla studentësh **(Evidence 3.30)**. Studenti zgjidh në mënyrë të pavarur një detyrë projektuese të lidhur me objektin e lëndës. Në detyra, jepen kryesisht elementë të veçantë projektues, me kërkesa të ngushta, që mund të mbulojë kapituj të veçantë të lëndës. Në projekte jepet një detyrë projektuese më e gjerë dhe komplekse, e cila mbulon pjesën më të madhe të disiplinës. Studenti punon nën drejtimin dhe kontrollin e pedagogut të lëndës. Në përfundim të detyrës, studenti vlerësohet nga pedagogu për cilësinë e punës të kryer.

• Praktika mësimore zhvillohet në përmbushje të planit mësimor të programeve të studimit. Praktika realizohet në Institucione të ndryshme bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që AU ka nënshkruar. Studenti në përfundim të saj dorëzon një relacion për punën e kryer të miratuar nga personi përgjegjës i Institucionit **(Evidencë 3.31)**.

**Standardi III.13 Programet e studimeve të shpallura zbatohen sipas strukturave të miratuara në nivel institucional dhe kombëtar.**

Programet e studimit në AU ofrohen konform ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor dhe akteve të tjera rregullatore të MAS. "Albanian University" ndërton dhe respekton strukturën si IAL për të ofruar 41 programe studimi në të tre Ciklet e Studimit bazuar në Statutin dhe Rregulloren e Përgjithëshme të tij.

Të gjitha programet e studimit janë të licensuara nga Ministria Përgjegjëse për Arsimin dhe të

| |
|---|
| akredituara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). |
| **Standardi III.14 Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike.**<br>Të gjitha programet e studimit në AU kanë të ndërthurura njohuritë teorike dhe ato praktike, duke i mundësuar studentëve aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në modulet teorike, si dhe duke u udhëhequr nga kompetencat që duhet të fitojë studenti në secilin program studimi. Gjatë vitit akademik, studentët aftësohen për kryerjen e veprimtarive të ndryshme mësimore si projekteve kërkimore, detyrave të kursit, punëve praktike, punëve laboratorike, projekteve të ndryshme sipas disiplinave mësimore.<br>Universiteti mbështet pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete ekstrakurrikulare, si: leksione të hapura, tryezat e rrumbullakëta, klubet studentore, konferenca studentore, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, workshope, duke i mundësuar kështu aplikimin e njohurive dhe aftësive të fituara., etj **(Evidencë 2.57), (Evidenca 3.32).** |
| **Standardi III.15 Programet zhvillohen me qëllim përfshirjen aktive të studentëve në përftimin e kompetencave.**<br>Në “Albanian University”, përdoren forma të studimit si seminare, laboratorë dhe praktika mwsimore të cilat zhvillohen në grupe të vogla studentësh, ku studentët pwrfshihen nw mwnyrw aktive duke përftuar kompetenca praktike nw disiplinat pwrkatwse **(Evidencë 3.33)**. Studentët njihen me pajisjet laboratorike, metodologjinë e matjeve dhe përpunimit të rezultateve, dhe fitojnë aftësi praktike në provat laboratorike **(Evidenca 3.29).** Realizojnë detyra kursi, të cilat janë individuale ose punë në grupe të vogla studentësh***)*** dhe e prezantojnë këtë detyrë në një orë mësimi Në detyrat e kursit, jepen kryesisht elementë të veçantë për t’u trajtuar, me kërkesa specifike të disiplinës. Studenti punon nën drejtimin dhe kontrollin e pedagogut të lëndës. Në përfundim të detyrës, studenti vlerësohet nga pedagogu për cilësinë e punës të kryer. |
| **Standardi III.16 Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim.**<br>Përputhshmëria e kurrikulave me nevojat e tregut dhe ndërthurja e njohurive teorike me ato praktike bëjnë që përgatitja e studentëve në fund të studimeve të rrisë mundësinë e tyre për punësim.Gjithashtu, programet e studimit kanw module që lidhen drejtpërsëdrejti me aftësimin profesional dhe me njohuri nga fusha specifike.<br>Programet e studimit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore përgatisin studentët që të aplikojnë dijet menjëherë pas diplomimit duke kontribuar në përmirësimin e shërbimit. Të gjitha lëndët që janë pjesë e formimit karakterizues kanë të parashikuar zhvillime të laboratorëve ose/dhe detyra kursi apo praktika mwsimore. Organizimi i praktikave profesionale në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë ndihmon shumë në formimin profesional të studentëve dhe përgatitjen e tyre për punësim. Në kurrikulat e programeve të studimit janë të parashikuara kredite për praktikat profesionale, të cilat ndryshojnë në varësi të ciklit të programit dhe programit të studimit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. |
| **Standardi III.17 Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë dhe të huaj.**<br>Të gjitha programet e ofruara në AU janë të organizuara në përputhje me procesin e Bolonjës, duke realizuar ndarjen në module me përmbajtje të detajuar dhe vlerësuar me kreditë sipas sistemit Europian tw transferimit dhe grumbullimit tw krediteve (ECTS). Programet e studimit hartohen dhe rishikohen në mënyrë që të kenë ngjashmëri me programe brenda dhe jashtë vendit duke bërë të mundur njëkohësisht njohjen dhe transferimin e studimeve. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe |

suplementin përkatës, i cili ofrohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) **(Evidencë 2.48 a,b).**

AU publikon në faqen e tij web (www.albanianuniversity.edu.al) informacion të plotë mbi programet e studimit të ofruara, kurrikulat dhe kriteret e pranimit, në gjuhën shqipe dhe angleze. Gjuha angleze është pjesë e planit mësimor që në vitin e parë të programeve të studimit. Studentët e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë të studimit kanë detyrim të dorëzojnë dëshminë e mbrojtjes së njërës prej 5 gjuhëve të huaja, sipas pikës 3 të nenit 78 të ligjit 80/2015 të certifikuar në nivel ndërkombëtar **(Evidencë 3.10)**.

Studentët kanë mundësi të transferojnë studimet në AU, në programe të të njëjtit cikël, në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, në përputhje me rregulloren e regjistrimit dhe transferimit **(Evidencë 2.45), (Evidencë 3.34), (Evidencë 3.35).** Institucioni, me mbështetjen e stafit akademik të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes mundëson mësimin e gjuhës shqipe nga studentët e huaj. (**Evidencë 3.36).**

Gjithashtu pranë AU ndjekin studimet e tyre studentë, të cilët vijnë nga trevat dhe vende të BE-së, të cilët i nënshtrohen legjislacionit shqiptar për regjistrim në programet e studimit.

**Standarde III.18 Institucionet pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.**

Organizimi i provimeve bëhet në përputhje me Rregulloren e Sekretarisë Mësimore **(Evidencë 3.37 Neni 7, faqe 5)** (https://albanianuniversity.edu.al/sq/sekretaria-mesimore/), Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit **(Evidencë 1.4, Neni 52, fq. 38)** dhe rregulloret e programeve të studimeve **(Evidencë 3.10).** Institucioni informon studentët diplomantë mbi procedurat e mbrojtjes së diplomës me provim formimi apo me temë diplome bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse të programeve të studimit **(Evidencë 3.10)**. Studentëve diplomantë, ju vihet në dispozicion baza e pyetjeve të provimit të formimit. Studentët që diplomohen me temë diplome, duhet të aplikojnë pranë strukturës përgjegjëse të programit të studimit për zgjedhjen e temës/projektit të diplomës **(Evidencë 3.38).** Studentëve gjithashtu, ju vihet në dispozicion nga departamenti përkatës, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe në faqen web të Institucionit, udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës (https://albanianuniversity.edu.al/sq/?s=Manual+per+teme+diplome). Gjatë procesit të provimeve me shkrim ruhet anonimiteti, përmes sekretimit të provimeve (**Evidencë 3.10).** Brenda 7 ditësh nga dita e përfundimit të provimit, provimet e korrigjuara nga pedagogu përgjegjës depozitohen pranë departamentit, ku bëhet ç'sekretimi i tezës. Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit, pasi të bëhet edhe ç'sekretimi i tyre. Ai njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjura apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin me një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit, Dekani i Fakultetit përkatës ngre një komision *ad hoc* në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët, të cilët kanë korigjuar provimet **(Evidencë 3.10).** Vlerësimi i provimeve i bëhet i njohur studentëve nga sekretaria mësimore duke respektuar parimin e konfidencialitetit, si dhe përmes sekretarisë online (https://au.pitagora.rash.al/) ku çdo student mund të informohet me anë të llogarisë personale mbi ecurinë e studimeve dhe rezultatet e provimeve.

**Standardi III.19 Institucioni siguron laboratorë të dedikuar në mbështetje të programeve të studimit dhe kërkimi shkencor/artistik.**

Në funksion të programeve të studimit të ofruara, institucioni vë në dispozicion një sërë laboratorësh mësimorë **(Evidenca 2.35).** Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike. Punët laboratorike, kryhen në prani të pedagogut të laboratoreve dhe laborantit (në funksion të tipologjisë së laboratoreve), për një mbarëvajtje sa më të mirë të tyre. Pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore, në kuadër të programit të integruar të

ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji” dhe Specializimeve afatgjata në fushën e Stomatologjisë, funksionon edhe Klinika Universitare Stomatologjike “Çerçiz Mingomataj” (https://albanianuniversity.edu.al/sq/klinika-universitare-2/) akredituar nga MSH (https://albanianuniversity.edu.al/sq/akreditohet-klinika-universitare-stomatologjike-e-albanian-university-ufo/). Po në këtë Fakultet në kuadër të programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi” dhe Masterit Profesional në “Terapi Manuale”, që prej vitit 2016, është ngritur Klinika e Fizioterapisë (https://albanianuniversity.edu.al/sq/klinika-e-fizioterapise/).

Gjithashtu, në kuadër të projektit "Innovation Eco-system to Accelerate the Industrial Uptake of Advanced Surface Nano-Technologies” (https://www.newskin-oitb.eu/), i cili zbatohet në kuadër të Qendrës “Albanian University Center” (https://albanianuniversity.edu.al/sq/au-center/) , parashikohet ngritja e laboratorit me fondet e alokuara **(Evidence R.16).**

Në kuadër të projekteve të përbashkëta midis Shqipërisë dhe Kosovës, të financuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit – AKKSHI, Departamenti i Inxhinierive ka fituar dhe është në fazë zbatimi të projektit në bashkëpunim me Departamentin e Mekatronikës në Universitetin e Prishtinës ”Hasan Prishtina”, ”Dizenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme”. (https://albanianuniversity.edu.al/sq/projekti-dora-robotike-nis-konkretizimin-e-tij/)

**Standardi III.20 Institucioni siguron pajisje laboratorike, infrastrukturë dhe shërbime në mbështetje të programeve të studimit.**

AU ushtron veprimtarinë e tij në pesë objekte të rindërtuara dhe rivlerësuara me materiale cilësore bashkëkohore, të shfrytëzueshme tërësisht vetëm për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, si dhe administratën, dhe plotësojnë tërësisht nevojat higjieno-sanitare duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. AU është larg zonave të zhvillimit industrial apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara sipas standardeve përkatëse. Godinat ndodhen në zonën e qendrës së Tiranës, dhe shumë pranë ndërtesave të karakterit rezidencial apo të shërbimeve të tjera për studentët. Pjesa më e madhe e godinave janë të termoizoluara; shumica e dritareve të institucionit janë me dopio-xham, jo vetëm për të siguruar temperatura të brendshme të qëndrueshme, por gjithashtu, për të evituar zhurmat nga jashtë. Institucioni në mënyrë të vazhdueshme mirëmban dhe rikonstrukton ambientet, të cilat shfaqin problematika në lidhje me izolimin për të shmangur lagështirën dhe jo vetëm.

Infrastruktura e Universitetit disponon të gjithë elementet e nevojshëm mësimore-shkencore universitare, si: ambiente për personelin akademik të pajisura me kompjutera, internet dhe të gjitha pajisjet e nevojshme; ambiente për personelin administrativ, klasa me hapësira të mëdha, të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, ambiente për laboratorë të degëve të ndryshme, ambiente për bibliotekën, senatin, salla audiovizive, salla kompjuterësh, salla për konferenca etj. (**Evidencë 3.39).** Për programet e ofruara nga Depatamenti i Art Dizajn, Departamenti i Inxhinierive dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Institucioni siguron infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e laboratorëve dhe seminareve **(Evidencë 2.35).** Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit që Universiteti ka me “Albanian College” në Tiranë, studentët e AU mund të shfrytëzojnë hapësirat sportive (fushë basketbolli, volejbolli, tenis, palestër etj.) të këtij kolegji për aktivitete/kampionate të ndryshme që zhvillohen gjatë vitit **(Evidencë 2.43).** AU plotëson normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, në përputhje me aktet ligjore në fuqi **(Evidencë 2.31).** AU për të gjitha programet e studimit, të cilat kanë pjesë të kurrikulës formimin praktik të studentëve garanton kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e tyre. Në funksion të tyre janë realizuar marrëveshje institucionale për praktikat e studentëve me institucione shtetërore dhe private si Arkiva e Përgjithshme e Shtetit, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Bashkia Tiranë, Agjencia e Shërbimit të Sportit, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" etj**. (Evidencë 2.39)**.

| |
|---|
| Normativat minimale të mësipërme janë pranuar për programe studimi të tilla si anglisht, mësuesi, psikologji, shkenca ekonomike, shkenca juridike, etj. (përgjithësisht për shkencat shoqërore). Për programe studimi në fushën e inxhinierisë, art dizajn-it apo mjekësisë normativat e mësipërme janë respektuar dhe në një pjesë të rasteve janë thuajse të dyfishuara. AU në pjesën më të madhe të hapësirave plotëson normativat teknike të ndriçimit natyror, sipërfaqja e dritareve mbulon minimalisht (15-20%) të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi në pjesën më të madhe të rasteve është i orientuar nga krahu i majtë i studentit. Për fakultetet që kanë më shumë se 200 studentë dhe nuk disponojnë shkallë emergjence, ka dalje dytësore, të cilat mund të konsiderohen si dalje emergjence. AU disponon certifikatat dhe aktet teknike për mbrojtjen kundra zjarrit për godinat e Institucionit dhe disponon sistemin e mbrojtjes kundra shkarkimit elektrik. AU në pjesën më të madhe të godinave të tij ka funksional sistemin e ngrohjes qendrore me kaldajë apo impiante kondicionimi. Gjithashtu, AU ka burime alternative për furnizimin me energji elektrike (gjenerator), si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit (depozita uji) duke lejuar të pandërprerë sigurimin e energjisë dhe ujit. |
| **Standardi III.21 Biblioteka, infrastruktura dhe shërbimet e saj sigurojnë akses në literaturë bashkëkohore të lidhur me fushat e studimit dhe kërkimit në programe.**<br><br>Infrastruktura e Universitetit disponon të gjithë elementet e nevojshëm mësimore-shkencore universitare, përfshirë dhe ambiente për bibliotekën.<br><br>“Albanian University” ofron një bibliotekë të pasur me tekste mësimore dhe literaturë plotësuese. Tekstet mësimore që “Albanian University” ofron për studentët janë të miratuara nga njësitë bazë përkatëse të AU-së dhe përdoren edhe në universitete të tjera. Në mjediset e AU janë vendosur tri bibloteka, të cilat shërbejnë edhe si salla studimi për studentët. Në to përfshihet literaturë me tituj të librave universitarë dhe botime artistike. Në këto bilioteka ka një numër të konsiderueshëm tituj librash.<br><br>Biblioteka është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë *online*. Mjediset e AU mbulohen me sinjal wi-fi.<br><br>Në ambjentet e bibliotekave, vihen në dispozicion të studentëve kompjutera/terminale, duke mundësuar kërkimin në internet dhe aksesimin e librarive *online* të këshilluara nga departamenti përkatës.<br><br>Universiteti përdor fonde të veçanta për blerjen e literaturës së re që del në tregun e librave universitarë, duke pasuruar kështu bibliotekat dhe duke u krijuar lehtësira studentëve në përdorimin e saj. “Albanian University” parashikon çdo vit fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën mësimore sipas propozimeve që vijnë nga departamentet e çdo Fakulteti **(Evidencë 3.25).** Pedagogët orientojnë studentët për shfrytëzimin e literaturës në bibliotekat e universitetit **(Evidenca 2.42**), si dhe në libraritë ***online.***<br><br>Në ambjentet e bibliotekave, vihen në dispozicion të studentëve kompjutera/terminale, duke mundësuar kërkimin në internet dhe aksesimin e librarive *online* të këshilluara nga departamenti përkatës.<br><br>Oraret e punës së bibliotekave në AU gjatë të cilave punonjësit u përgjigjen nevojave të studentëve, shpallen në mjediset dhe në faqen web të institucionit www.albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka/ Studentët regjistrohen në kartelat që iu lejojnë të marrin librat në ambientet e sallave të studimit brenda universitetit. |
| **<u>Përfundimet dhe Vlerësimi</u>**<br><br>Grupi i Vlerësimit të Brendshëm pasi konsultoi gjithë dokumentacionin mbi programet e studimit të ofruara në AU, organizimin dhe implementim e tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, vlerëson se standardet për fushën e programeve të studimit, |

mësimdhënies dhe vlerësimit përmbushen plotësisht.

Të gjitha programet e studimit ofrohen në përputhje me misionin, strategjinë e zhvillimit të AU, kapacitetin intelektual dhe infrastrukturor të tij, duke konsideruar politikat kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvillimit të Arsimit të Lartë, si dhe eksperiencat më të mira të universiteteve në botë dhe lidhjet e forta dhe gjithëpërfshirëse me përfaqësuesit e sektorit publik dhe privat që janë në gjendje të mbështesin Universitetin në përfitim të studentëve. Studentët informohen vazhdimisht për programet që ofrohen përmes faqes web të Institucionit, si dhe mjeteve të tjera të informimit.

Të gjitha programet janë hartuar/rishikuar dhe riorganizuar nga ekspertët më të mirë të fushave, në përputhje me ndryshimet e diktuara nga legjislacioni në fuqi. Programet pasqyrojnë një gërshetim shumë të mirë të njohurive teorike dhe praktike me objektivin për të orientuar sa më mirë studentët drejt tregut dinamik të punës në një shoqëri globale.

## IV- AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI

**Standardi IV.1 Institucioni përcakton fushat parësore të aktiviteteve kërkimore, shkencore/artistike.**

Në fillim të çdo viti akademik, Departamenti, si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore - shkencore të fakultetit **(Evidencë 1.1, Neni 16, pika 1, fq. 8)**, informon Zv. Rektorin për Kërkimin Shkencor dhe Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike mbi temën qendrore të aktiviteteve shkencore përgjatë tij **(Evidencë 4.1.a)**. Në rastet kur tema nuk ndryshon nga njëri vit në tjetrin, ajo konfirmohet automatikisht. Departamentet janë të angazhuara për të implementuar temën qendrore të kërkimit të tyre shkencor përmes aplikimeve të ndryshme në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe organizimit të aktiviteteve (leksione të hapura, konferenca, workshope etj.) me qëllim promovimin e rezultateve të tyre **(Evidencë R.12.b).** Tema qendrore e kërkimit shkencor, për shumë Departamente, ka qenë edhe në qendër të projekteve të propozuara për riorganizimin/hapjen e programeve të ciklit të tretë Doktoratë **(Evidencë 4.2),** në përputhje me aktet e reja ligjore.

Departamenti mbështet dhe nxit aktivitetet në drejtim të konkretizimit të temës qendrore të kërkimit shkencor, edhe përmes favorizimit të debatit shkencor duke organizuar leksione të hapura dhe tavolina të rrumbullakëta **(Evidencë 4.3).**

Studentët nxiten dhe mbështeten në konkretizimin e ideve të tyre inovative përmes detyrave të kursit, temave të diplomave etj., duke promovuar rezultatet e tyre me publikime në revistën shkencore të Institucionit "Optime" dhe përmes pjesëmarrjes në konferenca dhe simpoziume **(Evidencë 4.4)**
(https://albanica.al/optime/article/view/216/162)
(https://albanica.al/optime/article/view/218/164)
(https://albanica.al/optime/article/view/219/165)
(https://albanica.al/optime/article/view/220/166)
(https://www.albanica.al/optime/article/view/174)
Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e ideve të tyre, infrastrukturën laboratorike dhe mbështetjen e stafit të specializuar.

**Standardi IV.2 Institucioni zbaton prioritetet e aktivitetit kërkimor shkencor.**

Institucioni, në zbatim të strategjisë së tij për zhvillim **(Evidencë 1.6)**, mbështet dhe nxit zbatimin, zhvillimin dhe zgjerimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor të implementuara nga Departamentet **(Evidencë 4.1.b),** duke vënë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme (laboratore, biblioteka etj.) dhe burimet njerëzore, përmes financimeve **(Evidencë 2.31),** zgjerimit dhe forcimit të bashkëpunimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar **(Evidencë 4.5) (Evidencë 2.56.a.b)** , përmes rekrutimeve të reja të personelit akademik të kualifikuar në kërkim shkencor **(Evidencë 4.6),** përditësimit të literaturës dhe bibliotekave *online* **(Evidencë 2.42).**

**Standardi IV.3 Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin e veprimtarive kërkimore / artistike dhe shkencore.**

Institucioni inkurajon dhe mbështet bashkëpunimin me struktura dhe institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të kërkimit shkencor **(Evidencë 4.5)**, me qëllim aplikimin dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta (**Evidencë R.12.a**) dhe organizimin e aktiviteteve të tilla si konferenca, simpoziume, workshope etj. (**Evidencë 2.59**). Institucioni mbështet dhe inkurajon stafin akademik dhe Departamentet, në drejtim të kërkimit shkencor dhe projekteve, edhe përmes informimit dhe trajnimit (**Evidenca R.12.b**).

| |
|---|
| **Standardi IV.4 Institucioni dhe njësitë përgjegjëse për kërkimin shkencor/ artistik dhe inovacionin vlerësojnë përformancën e tyre në nivel institucional.**<br><br>Në fillim të çdo viti akademik, Departamentet, si njësi bazë e punës kërkimore - shkencore të fakultetit, paraqesin programin e tyre të aktiviteteve të kërkimit shkencor (**Evidencë 4.7.a**). Në fund të vitit akademik, në raportet e tyre vjetore, Departamentet paraqesin dhe vlerësojnë zhvillimin e aktiviteteve në përputhje me programin e parashikuar. Mbi bazën e raportit në nivel njësie bazë (**Evidencë 1.22**) bëhet një analizë dhe vlerësim në nivel njësie kryesore (**Evidencë 1.23**), dhe më pas në nivel institucional, i cili përmblidhet në raportin vjetor të Institucionit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/).<br><br>Në raportin vjetor të njësisë bazë, përfshihen edhe të dhënat e çdo anëtari të personelit akademik, i cili përmes formularit vjetor të vetëdeklarimit të kërkimit shkencor, deklaron veprimtarinë personale kërkimore - shkencore: botime kombëtare dhe ndërkombëtare, konferenca dhe projekte të fituara etj. (**Evidencë 4.8); (Evidencë 1.22**). |
| **Standardi IV.5 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij.**<br><br>Në aktet e tij rregullatore, Institucioni parashikon respektimin e pronësisë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, duke mbrojtur idenë se ato duhet të kontribuojnë në zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit (**Evidencë 4.9, Neni 4, fq. 4**).<br><br>Në rastet e projekteve apo patentave individuale të stafit të tij akademik, në funksion të realizimit të të cilave Institucioni vë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe stafin administrativ mbështetës, rregullohen përmes marrëveshjeve/kontratave të dedikuara (http://hyposens.eu/). |
| **Standardi IV.6 Në zbatim të prioriteteve të kërkimit shkencor/artistik, institucioni kanalizon veprimtaritë e kërkimit në nivel departamenti.**<br><br>Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. Departamenti përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive **(Evidencë 1.1, Neni 16, pika 1 - 2, fq. 8**); (**Evidencë 4.10, Neni 4, fq. 2**).<br><br>Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore e kërkimore. Grupet mësimore e kërkimore janë të përhershme, por ato mund të jenë edhe të përkohshme. Grupi mund të jetë edhe vetëm kërkimor (**Evidencë 1.1, Neni 16, pika 6, fq. 8); (Evidencë 4.10, Neni 7, pika 2, fq. 4).**<br><br>Misioni i departamentit, si njësi bazë e Fakultetit, është të nxisë, bashkërendojë dhe administrojë veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij (**Evidencë 1.4, Neni 25, pika 2, fq. 25); (Evidencë 4.10, Neni 3, pika 2.f, fq. 2**).<br><br>Përgjegjësi i departamentit është autoriteti akademik më i lartë drejtues i njësisë bazë, i cili drejton, organizon, koordinon dhe përgjigjet për punën mësimore dhe kërkimore shkencore në njësinë bazë dhe i raporton Dekanit (**Evidencë 1.4, Neni 26, pika 1, fq. 25; Evidencë 4.10, Neni 9, pika 1, fq. 4**).<br><br>Përgjegjësi i departamentit harton programin vjetor dhe planin financiar të veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore (**Evidencë 4.10, Neni 9, pika 3.p, fq. 5**). Departamenti mbështetet financiarisht në mënyrë transparente dhe të hapur. Bordi i Administrimit, me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre (**Evidencë 1.1, Neni 22, pika 4.c, fq. 14**). Në planin financiar institucional **(Evidencë R.16)** parashikohen fonde për kërkimin |

shkencor për çdo departament (**Evidencë 4.11**).

**Standardi IV.7 Institucioni miraton objekva të qarta për njësitë, grupet kërkimore / artistike dhe personelin akademik.**

Institucioni në planin e tij strategjik (**Evidencë 1.6**) dhe strategjinë e kërkimit shkencor (**Evidencë R.9**) paraqet objektiva të qarta për njësitë bazë/kryesore dhe personelin akademik në kuadër të zhvillimit të kërkimit shkencor, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, si dhe ka hartuar planin e masave, zbatimi i të cilave është në monitorim të vazhdueshëm nga Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin.

**Standardi IV.8 Institucioni synon rritjen e vazhdueshme të veprimtarive kërkimore/artistike e shkencore dhe garanton gjithëpërfshirjen e personelit akademik dhe studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë.**

Institucioni synon qendrueshmëri dhe rritje të vazhdueshme në organizimin e veprimtarive kërkimore – shkencore, konferenca, leksione të hapura, tavolina të rrumbullakëta, *workshop*-e, etj. (**Evidencë 4.7.b**), dhe pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare (**Evidencë R.12.a**), përmes konsolidimit të marrëdhënieve me institucionet partnere (marrëveshje bashkëpunimi) dhe konsolidimit dhe promovimit të imazhit të Institucionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Institucioni nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve në veprimtaritë e ndryshme kërkimore – shkencore, konferenca, leksione të hapura, tavolina të rrumbullakëta, *workshop*-e, etj. Institucioni, gjithashtu, organizon në mënyrë të përvitshme në nivel njësie bazë/njësie kryesore Konferenca studentore duke ju dhënë mundësinë të gjithë studentëve të paraqesin në to studimet e tyre (**Evidencë 1.17, fq 27-29, Tabela nr.6**).

**Standardi IV.9 Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor/artistik.**

Institucioni mbështet dhe inkurajon organizimin e konferencave ndërkombëtare, leksioneve të hapura, workshop-eve etj. **(Evidencë 4.7.b)** me qëllim prezantimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të stafit të tij akademik.

Institucioni mbështet publikimet shkencore të stafit akademik përmes financimeve (**Evidencë 4.12, Neni 11-13, fq.5–6; Evidencë 2.21**) dhe përmes revistës së saj "Optime" (http://albanianuniversity.edu.al/sq/revista-optime/). Gjithashtu, shtëpia botuese "AU Press" është një promovuese e mirë e veprimtarisë kërkimore shkencore të stafit akademik të institucionit, duke mundësuar publikimin e librave apo monografive **(Evidencë 4.13).**

Institucioni zhvillon aktivitete shkencore në bashkëpunim me Institucione dhe organizma kombëtare dhe rajonale duke patur një ndikim pozitiv në kulturën kërkimore - shkencore shqiptare dhe rajonale. Pjesëmarrja në këto aktivitete e studiuesve të ndryshëm nga Shqipëria, rajoni edhe më gjerë, është një tregues i qartë i saj (**Evidencë 2.59**).

**Standardi IV.10 Institucioni është përgjegjës për garantimin e cilësisë së punimeve shkencore/artistike dhe integritetin e tyre në nivel institucional.**

Institucioni kujdeset që puna shkencore e përgatitur nga stafi dhe studentët, në kuadër të veprimtarive të ndryshme kërkimore – shkencore të tij të jetë origjinale dhe cilësore. Të gjitha aktivitetet e organizuara nga Institucioni, konferencat ndërkombëtare **(Evidencë 4.14.a),** konferencat studentore **(Evidencë 4.14.b)**, simpoziumet **(Evidencë 4.14.c)** dhe revista e Institucionit "Optime" (https://albanica.al/optime ) kanë në strukturën e tyre Komitete Shkencore që kujdesen që punimet të jenë cilësore dhe origjinale duke

ruajtur integritetin e tyre në nivel institucional.

**Standardi IV.11 Institucioni i llojit universitet/akademi përcakton qartë detyrimet për personelin akademik në kuadër të pjesmarrjes në veprimtari kërkimore, studime, publikime e botime dhe i mbështet për përmbushjen e tyre.**

Institucioni nxit rritjen akademike të stafit akademik përmes pjesëmarrjes në konferenca të ndryshme dhe publikimit në revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë kuadër, një mbështetje janë konferencat e organizuara nga vetë Institucioni, në të cilat ka një pjesëmarrje të gjerë nga stafi akademik i tij. Gjithashtu, një mundësi e mirë për ta është edhe publikimi në revistën e Institucionit "Optime" me ISSN 2220-461X dhe me bord editorial (http://albanianuniversity.edu.al/sq/revista-optime/), tashmë edhe në platformën *online* Albanica (https://albanica.al/optime/).

Institucioni i mundëson, gjithashtu, stafit akademik, financim për një aktivitet shkencor ose botim shkencor në fushën që përbën prioritet për kërkimin shkencor për departamentin përkatës (**Evidencë 2.20.a, kontrata e punës PAE – Neni 9, pika a, fq. 4; Evidencë 2.21**).

**Standardi IV.12 Institucioni që ka përcaktuar në strategjinë e vet si prioritet kryesor kërkimin shkencor, fokusohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit dhe veprimtarive që lidhen me të.**

Institucioni periodikisht, në nivel njësie bazë ose njësie kryesore, organizon ose bashkëpunon në organizimin e Konferencave Ndërkombëtare me pjesëmarrjen e akademikëve të shquar nga Universitete të njohura ndërkombëtare **(Evidencë 4.14.a.b.c),** duke sjellë tendencat më të fundit në fushën e kërkimit shkencor brenda dhe jashtë vendit. Këto aktivitete, si dhe aktivitete të tjera si: *workshop*-e, leksione të hapura, trajnime etj. azhornojnë stafin akademik dhe atë ndihmës mësimor me të rejat më të fundit në fushat përkatëse. Punimet kërkimore shkencore të personelit akademik bëhen publike edhe nëpërmjet botimeve në revistën shkencore të Institucionit "Optime" me ISSN 2220-461X dhe me bord editorial (http://albanianuniversity.edu.al/sq/revista-optime/), tashmë edhe në platformën *online* Albanica (https://albanica.al/optime/). Gjatë vitit 2021, në këtë revistë u publikuan edhe punimet e pjesëmarrësve në modulin Jean Monnet "EUWEB" të organizuar nga Universiteti i Salernos, Itali, pjesë e së cilës është edhe "Albanian University" (link).

Personeli akademik i Institucioni prezanton studimet e tij kërkimore – shkencore në Konferenca brenda dhe jashtë vendit, si dhe i publikon ato në revista të njohura të fushave përkatëse. Gjatë treviteve të fundit stafi akademik i Institucionit, ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe kanë bërë publikime në revista ndërkombëtare (**Evidencë 4.15**).

Institucioni bashkëpunon me Institucione të huaja të Arsimit të Lartë në kuadër të kërkimit shkencor (**Evidencë 4.5**) Bashkëpunimet janë në zgjerim të vazhdueshëm. Përmes tyre është mundësuar pjesëmarrja/aplikimi në projekte në programe të ndryshme europiane të kërkimit shkencor dhe mobilitetit (Erasmus+, CEEPUS, Horizon, COST, etj.).

**Standardi IV.13 Institucioni ka prioritet përfshirjen në veprimtaritë mësimore e shkencore/artistike të personelit të huaj akademik dhe diasporës.**

Institucioni mbështet dhe nxit pjesëmarrjen e personelit të huaj akademik dhe diasporës në veprimtaritë mësimore dhe kërkimore shkencore. Bashkëpunimet e vazhdueshme me ta kanë qenë edhe iniciues të aplikimit në projekte të përbashkëta në thirrjet e projekteve dypalëshe përmes AKKSHI (Projekti "Disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme" projekt i fituar në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Hasan Prishtina (link); aplikime në projektet dypalëshe midis Shqipërisë dhe Turqisë (**Evidencë R.12.a**) etj.

**Standardi IV.14 Institucioni ka prioritet mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve dhe siguron mekanizmat për përfshirjen sa më shumë të tyre.**

Institucioni është i angazhuar në përfshirjen në programet e mobilitetit Erasmus+, CEEPUS, etj. duke mundësuar mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve, si në hyrje edhe në dalje të tij, për mësimdhënie/mësimnxënie dhe për trajnime (**Evidencë R.12.a**). Numri i mobiliteteve dhe Institucioneve partnere është gjithmonë në rritje.

Gjithashtu, ai mbështet mobilitetet e stafit të tij për kualifikime të mëtejshme jashtë vendit në kuadër të projekteve të vetë Institucionit **(Evidencë 4.16),** ose aplikimeve të tyre individuale (të tilla si Marie Sklodowska - Curie etj. **(Evidencë 4.17).**

**Standardi IV.15 Institucioni siguron vazhdimësi dhe rritje të impaktit të tij në fushën e kërkimit shkencor/artistik.**

Një nga objektivat strategjikë të Institucionit është kërkimi shkencor dhe inovacioni (**Evidencë 1.6.).**

Institucioni mbështet zhvillimin e kërkimit shkencor në fushat prioritare, të përcaktuara edhe në funksion të kapaciteteve infrastrukturore (**Evidencë 2.35**) dhe njerëzore të tij. Institucioni angazhohet në përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së kërkimit shkencor përmes investimeve dhe projekteve të fituara (**Evidencë R.13.a, R.13.b, R.13.c, R.13.d, R.13.e**) dhe rekrutimeve të reja në përputhje me objektivat e zhvillimit të kërkimit shkencor.

Institucioni bashkëpunon me organizma shkencorë kombëtarë. Për t'u përmendur këtu Akademia e Shkencave të Shqipërisë (**Evidencë R.11)** dhe Akademia e Studimeve Albanologjike **(Evidencë 4.18).**

Në projektet e Institucionit japin një kontribut aktiv studiuesit e rinj (në projektin "Disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme" projekt i fituar në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Hasan Prishtina, janë të angazhuar si kërkues shkencorë/teknikë dy pedagogë të Departamentit të Inxhinierive, MSc. Jozef Kola dhe MSc. Edvin Rustemi) pjesë e stafit akademik të Universitetit, të cilët janë kandidatë potencialë të programeve të studimit Doktoratë për të cilat Institucioni ka aplikuar.

Institucioni synon që të jetë pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të OCDE-së, dhe te Bashkimit Evropian (**Evidencë 1.6**)

**Standardi IV.16 Institucioni siguron transferimin e rezultateve të veprimtarive kërkimore e shkencore në funksion të zhvillimit të vendit, ekonomisë dhe shoqërisë.**

Institucioni organizon veprimtari të ndryshme shkencore si konferenca, leksione të hapura, tavolina të rrumbullakëta, *workshop*-e etj. me qëllim promovimin e rezultateve të kërkimit shkencor, në funksion të zhvillimit të vendit, ekonomisë dhe shoqërisë (**Evidencë 4.8**).

Institucioni bashkëpunon gjithashtu, me organizma shkencorë kombëtarë, Akademinë e Shkencave të Shqipërisë (**Evidencë R.11**) dhe Akademinë e Studimeve Albanologjike (**Evidencë 4.18**), përmes të cilave mundëson promovimin dhe transferimin e rezultateve të veprimtarive të tij kërkimore shkencore.

**Standardi IV.17 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij.**

Në aktet e tij rregullatore, Institucioni parashikon respektimin e pronësisë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, duke mbrojtur idenë se ato duhet të kontribuojnë në zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit (**Evidencë 4.10, Neni 4, fq. 4**).

Në rastet e projekteve apo patentave individuale të stafit të tij akademik, në funksion të realizimit të të cilave Institucioni vë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe stafin administrativ mbështetës, rregullohen përmes marrëveshjeve/kontratave të dedikuara.

**<u>Përfundimet dhe Vlerësimi</u>**

Institucioni ka si një nga objektivat e tij strategjikë kërkimin shkencor dhe inovacionin. Ai ka ngritur të gjitha strukturat për zhvillimin e kërkimit shkencor brenda tij dhe promovimin e rezultateve të arritura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përmes organizimit të veprimtarive të ndryshme, konferenca, leksione të hapura, tavolina të rrumbullakëta, *workshop*-e etj.

Institucioni ka intensifikuar aplikimet në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare përmes forcimit të bashkëpunimeve me partnerët e tij dhe rritjes së marrëveshjeve me Institucione të reja, gjithashtu, edhe përmes konsolidimit dhe promovimit të imazhit të tij në drejtim të kërkimit shkencor dhe si partner në projekte.

Institucioni mbështet dhe nxit mobilitetin e stafeve akademike dhe studentëve në programet europiane të mobilitetit Erasmus+, CEEPUS etj., duke patur vitet e fundit një rritje të konsiderueshme të mobiliteteve dhe duke mundësuar rinovimin e marrëveshjeve dhe marrëveshje të reja për vitet në vazhdim.

Institucioni ka rritur financimet në kuadër të kërkimit shkencor falë projekteve europiane, në të cilat është i angazhuar si partner, gjithashtu, në kuadër të projekteve kërkimore - shkencore në kuadër të aplikimit për riorganizimin/hapjen e programeve të ciklit të tretë "Doktoratë".

## V – STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| |
|---|
| **Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve.**<br><br>“Albanian University" harton projekte zhvillimi afatmesme, në përputhje me politikat e pranimit të studentëve, si pjesë e strategjisë së “Albanian Univeristy”. **(Evidencë 1.6*)*** Departamentet në bashkëpunim me dekanatet bazuar në ecurinë e programeve të studimit, numrin e rregjistrimeve ndër vite të studentëve për program studimi, bazuar në kriteret ligjore në fuqi si dhe bazuar në të dhënat e tregut të punës propozojnë kuotat e pranimit për vitin e ri akademik. Kuotat miratohen në Senatin Akademik **(Evidencë 3.5.a.b)** dhe dërgohen në MAS. Pranimi i studentëve të rinj mbështetet në legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloret e universitetit, burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore pritëse të miratuara nga MAS, **(Evidence 2.34.)**<br><br>Pranimi studentëve të vitit të parë bëhet publik nga portali U-Albania dhe rezultate shpallen dhe në gaqen zyrtare të AU (https://albanianuniversity.edu.al/sq/kandidatet-fitues-per-fazen-e-pare-ne-albanian-university-2021-2022/) (**Evidencë 5.1**) “Albanian Univeristy” në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të veta të studimit është e hapur drejt përthithjes së studentëve të huaj si edhe nga trevat, të cilët ndjekin procedurat e rregjistrimit sipas legjislacionit në fuqi. **(Evidencë 2.60).**<br><br>Universiteti ka raportin staf /student prej një anëtari të personelit akademik për numër studentësh brenda kërkesave legjislative, Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka raportin 1 pedagog/20 studentë, Fakulteti i Shkencave Shoqerore ka raportin 1 pedagog/26 studentë, Fakulteti i Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike ka raportin 1 pedagog / 35 studente. Në favor të studentëve për praktikat mësimore dhe laboratorët është parashikuar stafi ndihmës akademik i punësuar me kohë të plotë pranë AU sipas përcaktimeve ligjore (**Evidencë 5.2).** |
| **Standardi V.2 Institucioni u ofron mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre .**<br><br>Insitucioni kujdeset për studentin në çdo hap të tij. Informacioni për kriteret, kuotat dhe procedurën e aplikimit publikohet online në faqen zyrtare (https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/) **(Evidencë 5.3*)*** (https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/regjistrime-ne-au-sq/) **(Evidencë 5.4).**<br><br>AU informon studentët e ardhshëm (maturantët) për programet e studimeve që ofron, nëpërmjet Zyrës së Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve, si edhe me njoftime në websitin e tij. (https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/regjistrime-ne-au-sq/) **(Evidencë 5.5).**<br><br>Zyra e Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve gjatë periudhës së regjistrimeve ngre struktura të veçanta, që me mbështetjen e Burimeve Njerëzore të institucionit apo edhe me rekrutime të reja, shërben për rritjen e informimit të studentëve të ardhshëm.<br><br>Disa nga aktivitetet që ndërmerren në kuadër të politikave të pranimit të studentëve të rinj janë:<br><br>• Takimet këshilluese pranë Zyrës së Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve me Drejtuesit e Departamenteve dhe Dekanët e Fakulteteve. (**Evidencë 5.6)**<br><br>• Fushata mediatike – të cilat shërbejnë për njohjen me programet e studimit dh mënyrën e |

aplikimit për programet e AU (https://www.instagram.com/p/CgmMa5Mtxy8/) (**Evidencë 5.7).**

- Ditët e Orientimit të Maturantëve – Panairi Work and Study për maturantët e gjithë Shqipërisë; (**Evidencë 2.7; 2.9)**

Informimi realizohet edhe me publikimin për çdo vit të Manifestit Akademik të AU në version të printuar dhe elektronik, (https://albanianuniversity.edu.al/sq/manifesti-akademik/), (**Evidencë 5.8.a.b*)*** takime me maturantët, (https://albanianuniversity.edu.al/sq/ditet-e-informimit-te-maturanteve/), (**Evidencë 5.9)** si dhe organizohen ditët e orientimit për studentët për programet e studimit për çdo Fakultet, ku maturanët njihen me ambjentet e universitetit, stafin akadamik etj.. (**Evidencë 2.6)**

Institucioni ka një zyrë efikase, Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët, (https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-koordinimit-dhe-mbeshtetjes-ndaj-studentit/) e cila ka një rol kyç në mbështetjen e studentëve të AU. Kjo zyrë funksionon sipas një rregulloreje të posaçme dhe ka për qëllim orientimin, inkurajimin dhe mbështetjen e studentëve pranë "Albanian University" për zhvillimin e tyre personal dhe profesional (**Evidencë 5.10)**. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët organizon që në në fillim të çdo viti akademik Javën Orientuese për studentët e rinj, aktivitetet e përgjithshme dhe të ndara sipas programeve të studimit për njohjen me universitetin, pedagogët, mjediset, rregulloret, të drejtat dhe detyrimet e studentit sikurse dhe klubet studentore dhe Këshillin Studentor.

Për studentët e huaj ka një staf përfaqësues, i cili është në kontakt të ngushtë jo vetëm me takime në institucion, por edhe nëpërmjet komunikimeve elektronike. Gjithashtu, informacione në gjuhën angleze dhe italiane janë të disponueshme edhe në faqen zyrtare të AU.(https://albanianuniversity.edu.al/en/home/)

(**Evidencë 5.11*)*** https://albanianuniversity.edu.al/it/home-2/ (**Evidencë 5.12).**

Fakultetet dhe departamentet janë përgjegjëse për procesin e tutoriatit, mentorimit dhe udhëheqjes së studentit, që është një proces i vazhdueshëm përgjatë gjithë periudhës së studimit. Departamenti organizon dhe koordinon tutoriatin e studentëve të programit të tij të studimeve. Tutoriati i studentëve organizohet sipas një kalendari të përcaktuar paraprakisht nga Njësia Bazë, me pjesmarrjen aktive të pedagogëve/lektorëve dhe asistentë pedagogëve por edhe studentëve të viteve të fundit (nën koordinimin dhe drejtimin e lektorit të lëndëve) Institucioni ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët e lëndëve sipas departamenteve. Gjithashtu, studentët e viteve të fundit ndihmojnë në tutoriatin e studentëve më të rinj duke i orientuar për mënyrën e zhvillimit të provimeve në lëndë të caktuara ose aty ku studentët hasin më shumë vështirësi. (**Evidencë 5.13).**

**Standardi V.3 Institucioni përdor sistem efikas informimi për studentët.**

Universiteti ka struktura të përshtatshme administrative për të garantuar të drejtën e studentëve për mbështetje dhe informacion. Kontaktet e drejtuesve dhe zyrat e vëna në shërbim të studentëve, së bashku me adresat elektronike publikohen në faqen zyrtare (https://albanianuniversity.edu.al/sq/kontakte/) (**Evidencë 5.14)**.

Institucioni vë në dipozicion të studentëve informacion mbi ofertën akademike nëpërmjet manifestit akademik, (https://albanianuniversity.edu.al/sq/manifesti-akademik/), (**Evidencë 5.8 b)** si dhe çdo

informacion është i aksesueshëm në faqen zyrtare të tij. (https://albanianuniversity.edu.al/sq/oferta-per-aplikantet-e-raundit-te-pare-ne-au/) **(Evidencë 5.15).**

Një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve të rinj në programet e tyre e kanë edhe departamentet, pjesë e rëndësishsme e javës orientuese. Gjithashtu "Zyra e Karrierës dhe Alumnit" vendos në dispozicion të maturantëve dhe studentëve të rinj një "Udhëzues Orientues" **(Evidence 5.16)** që ndihmon ata të njihen me "Albanian University", me programet e studimit, mënyrën e regjistrimit dhe transferimit, bursat që "Albanian University" ofron, gjithashtu të njihen dhe me jetën studentore dhe klubet studentore. Gjithashtu, elementë të rëndësisëshëm të Rregulloreve dhe programit të studimit i bëhen me dije studentit që në takimet e para me departamentin, si p.sh. frekuentimi, të drejtat, detyrimet, mënyra e vlerësimit, kodi etikës etj,. Studentit i bëhen me dije Bibliotekat, vedodhjet e tyre, libraritë, mundësia e aksesit në bibliotekat *online* që universiteti disponon dhe vë në funksion të tyre. Universiteti ka një sistem të mirë organizuar të Klubeve Studentore dhe Këshilli Studentor (KSAU) (https://albanianuniversity.edu.al/sq/keshilli-studentor/) **(Evidencë 5.17)** bashkë me Senatorët e grupeve ndihmojnë në orientimin e studentëve të rinj, përfshirjen e tyre në aktivitete ekstrakurrikulare. KSAU funksionon sipas një rregulloreje të posaçme **(Evidencë 5.18).**

Gjithashtu, universiteti përdor faqen e internetit dhe tabelat e njoftimit të fakultetit dhe departamenteve për t'i pajisur studentët me informacionet që kanë nevojë.

I gjithë stafi akademik dhe studentët kanë adresën e tyre të postës elektronike të siguruar nga Universiteti. Universiteti ofron lehtësira të komunikimit të brendshëm të personelit dhe strukturave të ndryshme të tij. Përdorimi i PlatformësTeams është një mundësi më shumë për komunikim të brendshëm.

Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët vë në dispozicion të studentëve materiale dhe broshura informuese për t'i orientuar dhe për ti njohur ata mbi organizimin e institucionit, si dhe të drejtat e tyre nëpërmjet Manualit të Studentit, (https://albanianuniversity.edu.al/sq/manuali-i-studenteve/) **(Evidencë 5.19).**

Institucioni ka në kujdes përditësimin e sistemit të informacionit dhe organizon trajnime për stafin dhe studentët e tij duke hartuar dhe vënë në dispozion manuale udhëzimi për përdorimin e tyre. (https://albanianuniversity.edu.al/sq/manual-per-zhvillimin-e-provimeve-ne-exam-net/) **(Evidencë 5.20)** (https://albanianuniversity.edu.al/sq/manual-per-realizimin-e-mesimit-online/) **(Evidencë 5.21)** (https://albanianuniversity.edu.al/sq/trajnimi-i-stafit-akademik/) **(Evidencë 5.22).**

**Standardi V.4 Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale.**

Studentët janë të organizuar zyrtarisht në organin përfaqësues të Këshillit të Studentëve brenda "AU" (https://albanianuniversity.edu.al/sq/keshilli-studentor/) **(Evidencë 5.17).**

Ky këshill ka të drejtë të marrë pjesë në proceset e punës dhe jetës së universitetit duke u shprehur lirisht dhe pa kufizime. Universiteti nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e studentëve në jetën universitare.

